



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar i auditimit tematik të ushtruar në Bashkinë
Krujë dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim tematik

AUDITIM TEMATIK I USHTRUAR NË BASHKINË KRUJË DHE FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, NË LIDHJE ME PROCEDURAT E PROKURIMIT, ZBATIMIT TË KONTRATËS DHE PROCEDURËN E PRISHJES SË OBJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS 9 VJEÇARE + NDËRTIM PALESTRE THUMANË", BASHKIA KRUJË.

TIRANË, QERSHOR 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-9
I.a	Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit	3
I.b	Përmbledhje e gjetjeve kryesore	3-7
I.c	Opinionit i auditimit	7-9
II	HYRJA	9
1	Objektivat dhe qëllimi	10
2	Identifikimi i çështjes	10
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10
4	Përgjegjësitë e audituesve	11
5	Kriteret e vlerësimit	11
6	Standardet e auditimit	11
7	Metodat e auditimit	11-12
8	Dokumentimi i auditimit	12
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:	13-39
2.1	Mbi zbatimin e procedurave ligjore të prokurimit me objekt <i>"Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare + ndërtim palestre Thumanë"</i> , Bashkia Krujë.	13-23
2.2	Për zbatimin e punimeve dhe procedurës së prishjes në objektin <i>"Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare + ndërtim palestre Thumanë"</i> , në Bashkinë Krujë.	23-30
2.3	Mbi zbatimin e procedurave ligjore të prokurimit të projektit me objekt <i>"Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare Bashkia Krujë"</i> , në Fondin Shqiptar të Zhvillimit	30-39
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	39-46
V.	ANEKSE	47-48

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 nëMbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori në Bashkinë Krujë dhe në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në bazë të Autorizimit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 1028 prot., datë 13.10.2020, me afat auditimi deri në datën 29.10.2020, për auditimin tematik mbi nëProcedurën e prokurimit dhe zbatimin e punimeve në objektin nëRikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestres Thumanë nga Bashkia Krujë dhe mbi nëProgramin e zhvillimit të zonave të prekura nga tërmeti "Rindërtimi objekteve arsimore nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

I.2. Përmbledhje e gjetjeve kryesore.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi I procedurës së prokurimit të objektit në Bashkinë Krujë, u konstata: - Nga auditimi rezulton se shërbimi i realizimit të projektit nuk është prokuruar dhe nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë marrjen në dorëzim apo miratimin e këtij projekti nga ndonjë strukturë e specializuar e Bashkisë Krujë, por është firmosur pa protokoll nga Titullari. Nga auditimi rezulton se nuk ka komunikim shkresor zyrtar për hartimin e këtij projekti, nuk ka gjurmë të dhurimit të këtij projekti nga shoqëria projektuese nëXh & Mò Shpk. -Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer relacioni <u>në lidhje me integritetin strukturor të objektit</u> dhe Relacioni Gjeologjik për palestrën. Në projektpreventivin e punimeve <u>nuk është parashikuar asnjë zë pune që ka të bëjë me përfundimin strukturor të shkollës, ose ndërhyrje në strukturën mbajtëse të objektit. Punimet ndërtimore të shkollës përfshijnë vetëm punime për përmirësimin e rifiniturës (suvatime, hidroizolime, shtresa, etj) dhe punime elektrike dhe hidraulike.</u> - Nga auditimi konstatohet se, shoqëria nëXh & Mò Shpk, e cila është hartuesja e projektit të zbatuar, rezulton të jetë edhe kolaudatore e realizimit të punimeve të objektit. Ky veprim	<i>Faqet 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i>	E lartë	Nga Bashkia Krujë, për procedurat e prokurimit të punëve publike që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrën masa të zbatohen rregullat e prokurimit publik të projekteve apo shërbimeve të konsulencës, duke realizuar konkurse projektimi apo shërbime konsulente, në mënyrë që të përcaktohet oferta ekonomikisht dhe teknikisht më të favorshme, si dhe të ndiqen rregullat ligjore për zbatimin e kontratës së shërbimeve Nga Bashkia Krujë, për procedurat e prokurimit të punëve që do

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	është në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit Nr.8402 nëPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò. - Llogaritja e fondit limit është bërë nga projektuesi dhe nga auditimi rezultoi se 98 zëra pune nga 218 gjithsej, janë të cituara nëanalizëò (nuk ndodhen në manualin e çmimeve) dhe në dosje nuk ndodhet asnjë analizë çmimi. - Nga auditimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, u konstatuan shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), si më poshtë: 1) Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 61, pika 2; 2) Ndërkohë kur objekti i kontratës nëRikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestredò, është me vlerë të plotë 58,892,767 lekë (N.P. 2, Klasifikimi C), konstatohet që janë kërkuar kategorizime më të larta, në krahasim me zërat dhe me volumin e objektit (pika të licencës NP-1C, NP-2E, NP-3E, NP-7B, NP-12D dhe NS-1D, NS-2C, NS-4E, NS-8E, NS-9E, NS-10E, NS-12B, NS-13B, NS-14D, NS-18B), jo në përputhshmëri me volumin dhe natyrën e objektit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 "Kontrata për punë publike" pika 5, duke ngushtuar konkurrencën dhe favorizuar operatorë të caktuar që disponojnë këto pika dhe kategorizim të Licencës. 3) Është kërkuar që Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diploma dhe të figurojnë në listëpagesa për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, <u>1 (një) mjek të përgjithshëm</u>, i cili është kriter i përcaktuar në një VKM të shfuqizuar. 4) Janë kërkuar kriterë kualifikimi për stafin, jo në përputhje me natyrën dhe volumin e punimeve - AK kërkon që për personelin dhe fuqinë punëtore Kandidati/ofertues duhet të vërtetojë se disponon numrin e nevojshëm të punonjesve për zbatimin e kontrates dhe për këtë provuar këtë kusht, duhet të ketë një punësim mesatar			zhvillohen në vazhdimësi, të marren masa të zbatohen rregullat e legjislacionit të disiplinimit të punimeve, ku të përcaktohen kolaudatorë që nuk kanë lidhje apo konflikt me projektimin e veprës. Bashkia Krujë, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i vendosur të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën dhe për të mos favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar, duke dhënë argumente për secilin kriter me procesverbal, i cili të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	për periudhën Mars 2018 - Mars 2019 i te paktën 200 (dyqind) personave, duke përfshirë stafin e përhershëm. Numri i personave dhe periudha Mars 2018-Mars 2019, <i>nuk është argumentuar nga NJP vendosja e tyre, në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës</i>. Me këtë kriter, AK vështirëson pjesëmarjen e operatorëve ekonomikë, duke drejtuar ofertuesit drejt bashkimit të operatorëve ekonomikë, me qëllim arritjen e numrit të punonjësve, <i>etj.</i> <u>5) Janë kërkuar kriteret kualifikimi për mjetet dhe pajisjet, jo në përputhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës, duke ngushtuar më tej konkurrencën. si më poshtë:</u> - 11 vinca, freza, çekiç hidraulik, Rul, Autovinc, Autobetoniere, Autopompë betoni, Nyje prodhim betoni, Nyje inertesh, sasi e madhe kamionash etj, në mënyrë të pajustifikuar e të paargumentuar teknikisht në lidhje me natyrën dhe volumin e punimeve. - Në pikën një kërkohej që Operatori ekonomik duhet të disponojë <u>makineri për prodhimin e dritareve duro plastike</u> si: Tabelë lajmerimesh me kanata, Sharrë bordurash xhami, Pluhurthithëse të ajrit, Frezë kopjesh, Frezë automatike me carje me ujë, Sharrë me miter te dyfishtë, makineri saldimi lëndësh plastike, Konvenjer transporti, Zinxhirë saldimi, Stacion automatik manovrimi, Sharrë menteshash, Presë për venien e xhamave, Frezë leshimi, Tavolinë me rrëshqitje.			

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
2.	Nga auditimi i procedurës së prokurimit, rezultoi se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 15.06.2019, OE në SHPK është kontraktori kryesor dhe angazhohet për kryerjen e 70 % të punimeve. Për pasojë në zbatim të VKM nr. 914, datë datë 29.12.2014 në miratimin e rregullave të prokurimit publik, nën 74 pika 3 ku citohet<i>secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DT. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje</i>, OE në SHPK duhet të kishte mesatarish për periudhën e kërkuar, 140 punonjës (70% e 200 punonjësve të kërkuar), ndërkohë që ka mesatarisht 122 punonjës. Për këtë arsye, BOE i shpallur fitues, duhej skualifikuar.	<i>Faqet 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i>	E lartë	Bashkia Krujë, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punë publike, mallra/shërbime me shkelje ligjore, për shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë me mangësi në plotësimin e kriterëve, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.
3.	Nga auditimi i procedurës së prishjes së objektit rezultoi se, objekti dy kate i në Shkollës 9-vjeçare, Thumanë, mbasi janë konstatuar dëmtime strukturore të tij, për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019, është prishur në datë 04.12.2019, ku është mbajtur dhe procesverbali i prishjes Nr.7865, datë 10.12.2019, nënshkruar nga S.Sh, Kryeinspektori i IMTV-së Bashkia Krujë, R.T, përfaqësues i IKMT dhe I. Dh., përfaqësues i Policisë së Shtetit. Për këtë objekt kishte dalë Vendimi i Shembjes Nr.241 datë 02.12.2020, i firmosur nga Kryeinspektori i IMTV të Bashkisë Krujë, z.S. Sh., ku citohen arsyet e prishjes. Ky vendim është në tejkalim të kompetencave të Kryeinspektorit të IMTV-së, sepse objekti në fjalë, nuk është subjekt i Nenit 5, pika d, të Ligjit Nr. 9780 datë 16.07.2007 në inspektimin dhe mbrotjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme, i ndryshuar, sepse objekti nuk ishte i kundraligjshëm. Objekti përpara se të prishej, duhet të ishte pajisur me nëleje për prishje ndërtimi, tagër i titullarit të Bashkisë Krujë, bazuar në Nenin 39, pika 1, të Ligjit 107/2014 në planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, i ndryshuar, sipas të cilit nëleja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim,	<i>Faqet 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i>	E lartë	Nga Titullari i Bashkisë Krujë, në rastet e prishjes së objekteve të dëmtuar nga tërmeti ose jo, të cilët nuk janë objekte të paligjshme, të merren masa për nxjerrjen e nëlejes për prishje ndërtimi, sipas përcaktimeve në legjislacionin e planifikimit dhe kontrollit të territorit; Nga Titullari i Bashkisë Krujë, të merren masa që në vazhdimësi, prishjet e ndërtimeve të dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019, të realizohen sipas Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 "Për Përballimin e

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<i>restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji dhe Nenin 11, pika ç, të VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 në Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit.</i> Përvec procesverbalit dhe vendimit të prishjes, në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Bashkia Krujë, në lidhje me realizimin e prishjes së objekti është edhe Aktkonstatim Nr.01 datë 03.12.2019, i mbajtur nga një grupi inspektimit, i përbërë nga z. G. I. dhe znj. Xh.D., përkatësisht mbikëqyrës dhe kolaudator i kontratës për Rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë dhe z. A.I., inxhinier, për të cilët nuk ka asnjë urdhër apo detyrë të ngarkuar nga Bashkia Krujë.			Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore", i hartuar për këtë qëllim, si dhe vlerësimi teknik të bëhet nga persona të autorizuar.
4.	Nga auditimi në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve, rezultoi se nga verifikimi në terren për prishjen e objektit, konstatohet se nga AK nuk janë marrë masa për evidentimin dhe inventarizimin e materialeve, të cilat nuk janë prekur nga shembja e objektit, pasi kanë qenë zëra dhe pajisje jashtë objektit dhe AK nuk ka realizuar vlerësim përpara prishjes së objektit. Zërat e punimeve, të cilat nuk janë prekur nga prishja e objekti (pasi janë vendosur jashtë objektit), në total kanë vlerën prej 5,627,178 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik", pika 108.	<i>Faqet 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i>	E lartë	Titullari i Bashkisë Krujë, të marrë masa nëpërmjet një grupi pune të ngritur për këtë qëllim dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mosveprimin në lidhje me inventarizimin dhe ruajtjen e materialeve të paprekura nga prishja e godinës së shkollës në Thumanë dhe të ndjekë të gjitha procedurat për arkëtimin e vlerës prej 5,627,178 lekë pa TVSH.
5.	Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike të objektit "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë", Bashkia Krujë", rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 1,477,573 lekë pa tvsh	<i>Faqet 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i>	E lartë	Nga Bashkia Krujë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,477,573 lekë pa tvsh nga BOE fitues në E0 SHPK & në R0 SHPK & "S" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën Nr. 4290 prot datë 13.06.2019, vlerë

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
				kjo e cila përbën dëm ekonomik, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

I.3. Opinioni i auditimit mbi përputhshmërinë.

Për drejtimin e Bashkisë Krujë:

Ne kemi audituar përputhshmërinë e prokurimit të fondeve publike për objektin ñRikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestë, Thumanë, në subjektin ñBashkia Krujë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të ligjeve rregullave dhe rregulloreve, termave apo kushteve të vendosura, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në fushën e prokurimeve publike.

Opinion "I Kundërt": Nga auditimi mbi përputhshmërinë në fushën e prokurimit dhe të zbatimit të kontratës së punimeve, mbështetur në standardet INTOSAI 4000 dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, për objektin ñRikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestë, Thumanë, në subjektin ñBashkia Krujë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, në lidhje me kriteret e vendosura në procedurën e prokurimit të këtij objekti, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur **janë materiale dhe të përhapura**, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e **një opinionit të kundërt për përputhshmërinë**. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme dhe ofrojnë një siguri të arsyeshme për dhënien e opinionit.

Baza për opinion "E kundërt":

- **Mbi Projektpreventivin**

- Preventivi i punimeve dhe i gjithë dokumentacioni teknik i objektit është hartuar nga shoqëria ñXh & Mò SHPK. Nga auditimi rezulton se shërbimi i realizimit të projektit nuk është prokuruar dhe nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë marrjen në dorëzim apo miratimin e këtij projekti nga ndonjë strukturë e specializuar e Bashkisë Krujë, si dhe nuk ka gjurmë të zhvillimit të këtij projekti dhuratë nga shoqëria projektuese, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 ñPër prokurimin publik, i ndryshuar, neni 35 "Konkursi i projektimit" dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 37, 38 dhe 77.

-Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer relacioni **në lidhje me integritetin strukturor të objektit** dhe Relacioni Gjeologjik për palestrën.

Në projektpreventivin e punimeve **nuk është parashikuar asnjë zë pune që ka të bëjë me përforcimin strukturor të shkollës, ose ndërhyrje në strukturën mbajtëse të objektit**, pavarësisht se në narrativën e tij, relacioni citon që objekti është i dëmtuar si nga tërmeti i Korrikut 2018, ashtu edhe nga amortizimi i saj për shkak të vjetërsisë së objektit (viti i ndërtimit 1964). Nuk është dhënë asnjë opinion nga projektuesi, nëse godina duhej prishur dhe rindërtuar, apo duheshin përforcuar strukturat mbajtëse të objektit.

- **Mbi llogaritjen e fondit limit**

Nga auditimi rezultoi gjithashtu, se **98 zëra pune nga 218 gjithsej**, janë të cituara në analizë (nuk ndodhen në manualin e çmimeve) dhe nuk janë hartuar analiza çmimi.

- **Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit**

Nga auditimi u konstatua se ka patur devijime nga legjislacioni i prokurimeve në lidhje me vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat kanë sjellë si pasojë mosnxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit, duke favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar. Devijimet u konstatuan në kriterin për numrin e lartë prej 200 punonjësish, numrin e lartë dhe lloji i mjeteve dhe pajisjeve në mospërputhje me natyrën dhe volumin e punimeve, kërkesa për të patur në listëpagesa inxhinier me certifikatë në Auditori të Sistemit të Menaxhimit të Energjisë, mjek të përgjithshëm, licencë për Mbrojtjen nga Zjarri të lëshuar nga QKL me Kod 1/2/A, në kriterin skualifikues për vizitën në kantier, etj.

- **Mbi zbatimin e kontratës**

Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt në Rikonstruksionin i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestere, Thumanë, Bashkia Krujë, sipërmarrësi BOE në SHPK & në SHPK & "S" SHPK, ka përfituar më tepër vlerën 1,477,573 lekë pa tvsh, si diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

- Nga verifikimi në terren konstatohet se mungojnë zëra dhe pajisje të cilat nuk kanë qenë brenda objektit të dëmtuar nga tërmeti dhe që kishte mundësi për t'ia kontabilizuar dhe ripërdorur apo nxjerrë në ankand, në vlerën 5,627,178 lekë pa TVSH. Nga AK nuk janë marrë masa për kontabilizimin apo dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve, të cilat nuk ishin prekur nga tërmeti. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik*", pika 108.

- **Mbi zhvillimin e procedurave, vlerësimin e ofertave dhe shpalljen e fituesit:**

Nga auditimi ka rezultuar se në procedurën e zhvilluar me objekt në Rikonstruksionin i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestere, Thumanë, Bashkia Krujë, nga ana e KVO-së është vepruar në kundërshtim me LPP, neni 46 në Kualifikimi i ofertuesve, pika 1 dhe neni 53 në Shqyrtimi i ofertave, pika 3, pasi BOE të shpallur fitues nuk i kanë plotësuar kriteret për kualifikim. Operatori fitues duhet të ishte skualifikuar dhe meqenëse është ofertues i vetëm i kualifikuar, duhej bërë anulimi i procedurës dhe filluar një procedurë e re prokurimi.

- **Mbi prishjen e "Shkollës 9-vjeçare Thumanë"**

Nga auditimi ka rezultuar se procedurat e ndjekura për prishjen e objektit "Shkolla 9-vjeçare, Thumanë", e dëmtuar nga tërmeti, janë kryer në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe si pasojë edhe dokumentet e produktit të këtyre procedurave (akt konstatimet) nuk janë në përputhje me kriteret ligjore. Procesi i vendimmarrjes veçanërisht për prishjen e detyruar të objektit është i pabazë dhe mbart riskun që njëkohësisht të jetë edhe i gabuar.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Krujë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Krujë, janë përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi, të cilat duhet të mbështeten nga një sistem i kontrollit të brendshëm funksional. Staf drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të prokurimeve publike dhe përdorimin e burimeve financiare të vëna në dispozicion në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objekti i auditimit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse procedurat e prokurimit publik, nuk paraqesin anomalitë materiale, si nga ana sasiore dhe cilësore, nëse veprimtaria e subjektit të audituar në fushën e prokurimeve publike, është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI (100, 4000), audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatimin e procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave publike, në përputhje me ligjet dhe rregullat.

II. HYRJJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 nëPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSH, në zbatim të autorizimit nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1028, datë 13.10.2020, në Bashkinë Krujë dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit, nga data 13.10.2020 deri në datën 29.10.2020, për procedurën e prokurimit dhe zbatimin e punimeve në objektin nëRikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestere Thumanë dhe mbi programin e zhvillimit të zonave të prekura nga tërmeti "Rindërtimi objekteve arsimore, u krye auditimi i përputhshmërisë në Bashkinë Krujë dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Alush Zaçe, përgjegjës grupi,
2. Aldo Kume, anëtar
3. Idlir Dervishi, anëtar (Ekspert i jashtëm)

a) Titulli:

Raporti Përfundimtar i Auditimit Tematik të Përputhshmërisë mbi zbatimin e procedurave ligjore, në Bashkinë Krujë dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në lidhje me procedurat e prokurimit, zbatimit të kontratës, procedurën e prishjes së objektit nëRikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare dhe ndërtim palestere Thumanë dhe mbi programin e zhvillimit të zonave të prekura nga tërmeti "Rindërtimi objekteve arsimore.

b) Marrësi:

Raporti Përfundimtar i Auditimit i adresohet Kryetarit të Bashkisë Krujë Z. A.B. dhe Drejtorit Ekzekutiv të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Z. D.A..

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

Objekti i këtij auditimi është auditimi i procedurës së prokurimit dhe zbatimit të punimeve në objektin nëRikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestere Thumanë, procedurat e prishjes së shkollës dhe programi i zhvillimit të zonave të prekura nga tërmeti "Rindërtimi objekteve arsimore.

Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë

zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj.

Çështja të cilat do të trajtohen në këtë projekt, lidhet me auditimin mbi vlerësimin e rikonstruksionit të shkollës në Thumanë, procedurën e prishjes së saj dhe të rindërtimit.

b) Identifikimi i çështjes:

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi i procedurave të prokurimit, zbatimit, prishjes dhe rindërtimit të shkollës "*Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestre Thumanë*".

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit Nr.prot.1028, datë 13.10.2020.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Krujë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, janë përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi, të cilat duhet të mbështeten nga një sistem i kontrollit të brendshëm funksional. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të prokurimeve publike dhe përdorimin e burimeve financiare të vëna në dispozicion në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse procedurat e prokurimit publik, nuk paraqesin anomali materiale, si nga ana sasiore dhe cilësore, nëse veprimtaria e subjektit të audituar në fushën e prokurimeve publike, është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI (100¹, 400², 4100³), audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatimin e procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave publike, në përputhje me ligjet dhe rregullat.

e) Kriteret e vlerësimit:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*;
- Ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 *“Për buxhetin e vitit 2017”*;
- Ligji nr. 109/2017, dt. 30.11.2017 *“Për buxhetin e vitit 2018”*;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr.8402 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*;
- Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*;

¹ “Auditimi i përputhshmërisë përcakton se deri në ç’masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi.”

² (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

³ ISSAI 4100 “Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë për auditimet që kryhen veçmas nga auditimi i pasqyrave financiare”;

- VKM nr. 629, datë 15.7.2015 *ËPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*;
- Ligji Nr. 9780 datë 16.07.2007 *ËPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme*.
- Ligji 107/2014 *ËPër planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit*.

f) Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *ËPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

- ISSAI 100 - (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
- ISSAI 4000 *ËStandarti i Auditimit të Përputhshmërisë*
- ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e - SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etikës.

g) Metodat e auditimit

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar pas të dhënave të vëna në dispozicion nga subjekti i audituar. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj.

h) Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim, pas shqyrtimit observacioneve të paraqitura nga subjekti mbi Projektraportin, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Krujë dhe në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, u krye në kuadër të autorizimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për procedurën e prokurimit dhe zbatimin e punimeve në objektin *ËRikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestre Thumanë* dhe mbi programin dhe zhvillimin e zonave të prekura nga tërmeti "Rindërtimi objekteve arsimore". Në këto subjekte, u evidentuan shkelje ligjore në fushën e studim-projektimit, në procedurën e prokurimit, si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e prokurimeve si dhe me dëm ekonomik në zbatim të projektit të investimit. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- Objekt i auditimit: Rregullshmëria për procedurat e realizuara për objektin "Rikonstruksionin e shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestre Thumanë" dhe programin "Rindërtimi objekteve arsimore, që ka të bëjë me ndërtimin e këtij objekti.

- Qëllimi i auditimit: Auditimi tematik i procedurave administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi. Evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, dhënia e opinionit për shkallën e ndjekjes së tyre si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vijim.

- Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të institucioneve me qëllim dhënien e opinionit, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën nga inicimi për rikonstruksionin e shkollës Thumanë, zbatimi i punimeve, prishja dhe rindërtimi i saj.

IV. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT, SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestre Thumanë", në Bashkinë Krujë.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve fizike të ndodhur në Bashkinë Krujë dhe nga dokumentacioni i shkarkuar nga faqja zyrtare e APP-së për këtë prokurim, u konstatua se:

Me shkresën nr. 2907 prot., datë 19.04.2019 në *Urdhër prokurimi për fillimin e procedurave të prokurimit për "Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestre, Thumanë"*, është urdhëruar fillimi i procedurës së prokurimit si më sipër. Objekti i prokurimit do të kontraktohet me vlerë të plotë 70,671,320 lekë (me TVSH), por për vitin 2019 do të financohet 30,388,668 lekë me TVSH, ndërsa pjesa tjetër prej 40,282,652 lekë me TVSH do të financohet në vitet 2020. Gjithashtu në këtë urdhër ngrihet njësia e prokurimit e përbërë nga G. H., E. C., A. G.

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestre Thumanë", Bashkia Krujë		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 318 Prot., datë 19.04.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 318 Prot., datë 19.04.2019 Njesia e prokurimit G.H, Personi i ngarkuar E.C, anëtare A.G, anëtare, jurist Hartuesit e Kritereve të Veçanta 1. R.B Pjesa teknike 2. G,H, Pjesa Juridike	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 319 Prot., datë 19.04.2019 F.C. kryetar I.H. anëtar S.P anëtar
2. Lloji i Procedurës "Procedurë e Hapur i Punë Publike"		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 58,892,767 lekë REF-19039-04-19-2019	6. Oferta fituese (pa tvsh) BOE në SHPK & në SHPK & "S" SHPK 58,785,179 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 107,588 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 23.05.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë + FZHR	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës Nuk ka	13. Përgjigje Nuk ka

Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës 4290 prot., datë 13.06.2019	15. Vlera kontratës (me tvsh) 70,542,215 lekë	16. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 3 muaj

- Me urdhërin nr. 317 prot. Datë 19.04.2019, prot. 2876, caktohet grupi i punës për përcaktimin e kriterëve të kualifikimit, i përbërë nga R.B., me detyrë Drejtor i DPKZHT dhe G.H, me detyrë përgjegjës për prokurimet.

- Me urdhërin nr. 319 prot. Datë 19.04.2019, prot. 2908, është caktuar përbërja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nga F.C., I.H., S.P..

Titulli i Gjetjes Nr.1	Shmangie e procedurave të prokurimit për konkurs projektimi.
Situata	1. Projekt - Preventivi i punimeve të objektit "Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestere, Thumanë dhe i gjithë dokumentacioni teknik është hartuar nga shoqëria ñXh & Mò Shpk. Nga auditimi rezultoi se shërbimi i projektit nuk është prokuruar dhe është shmangur procedura prokuruese për konkurs projektimi ose shërbim konsulence dhe nuk ka komunikim shkresor për hartimin e këtij projekti. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk ka gjurmë të zhvillimit të këtij projekti dhuratë nga shoqëria projektuese ñXh & Mò Shpk, përfaqësuar nga Xh.D. me Licencë projektim-mbikëqyrje-kolaudim nr. K72105003E. Nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë marrjen në dorëzim apo miratimin e këtij projekti nga ndonjë strukturë e specializuar, por është firmosur pa protokoll nga Titullari, ne kundërshtim me me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 35 "Konkursi i projektimit" dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 37, 38 dhe 77.
Kriteri	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar. neni 35 " Konkursi i projektimit" dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 37, 38, 77.
Ndikimi/Efekti	Shmangie e procedurave prokuruese për konkurs projektimi ose shërbim konsulence me pasojë përdorimin e një projekti jo të plotë dhe të pa miratuar nga struktura të specializuara.
Shkaku	Shmangie e procedurës për konkurs projektimi
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	- Titullari i Bashkisë Krujë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin e një projekti të pamiratuar. Nga strukturat e ngarkuara nga titullari i Bashkisë Krujë, për procedurat e prokurimit të punëve publike që do zhvillohen në vazhdimësi, të merren masa të zbatohen rregullat e prokurimit publik të projekteve, duke realizuar konkurse projektimi apo shërbime konsulence. Në rast se projekti do të ndjekë rrugën ligjore si dhuratë nga shoqëritë projektuese, AK të marrë masa për marrjen në dorëzim të projektit me grup të specializuar, si dhe kontabilizimin e tij.

Titulli i Gjetjes	Mos vlerësimi mbi integritetin strukturor të objektit "Shkolla 9-vjeçare"
--------------------------	--

Nr.2	Thumanë, Bashkia Krujë".
Situata	1. Projekt - Preventivi i punimeve i hartuar nga shoqëria nXh & Mò SHPK u konstatua se nuk ka asnjë relacion <u>në lidhje me integritetin strukturor të objektit</u>. Mungojnë Relacioni gjeologjik për palestrën, Raporti Sizmik, në kundërshtim me Kushtet Teknike të Projektimit (KTP). <i>Në projekt është përfshirë:</i> - Projekti arkitektonikë i shkollës (gjithsej 15 fletë); - Projekti elektrik, hidraulik dhe I ngrohjes së shkollës; - Relacioni Teknik; - Specifikimet teknike; - Projekti arkitektonikë i palestrës (gjithsej 16 fletë); - Grafiku i punimeve; - Preventivi (vlera 58,892,767 lekë pa TVSH) - Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, 2. Në preventivin e punimeve <u>nuk është parashikuar asnjë zë pune që ka të bëjë me përforcimin strukturor të shkollës</u>, ose ndërhyrje në strukturën mbajtëse të objektit, pavarësisht se në narrativin e tij, relacioni citon që objekti është i dëmtuar si nga tërmeti i Korrikut 2018, ashtu edhe nga amortizimi i saj për shkak të vjetërsisë së objektit (viti 1964). <u>Punimet ndërtimore të shkollës, që kanë filluar në 13.06.2019 dhe përfunduar në 13.09.2019, përfshijnë vetëm punime për përmirësimin e rifiniturës (suvatime, hidroizolime, shtresa, etj.) dhe punime elektrike dhe hidraulike.</u> Në kushtet e rënies së tërmetit të datës 26/11/2019, të dëmeve dhe pasojave që patën në banesa dhe ndërtime të tjera, objekti dy kate i nShkollës 9-vjeçare, Thumanë mbasi janë konstatuar dëmtime strukturore të tij, është prishur në datë 04.12.2019, ku është mbajtur dhe procesverbali i prishjes Nr.7865 datë 10.12.2019. - Rindërtimi i objekteve arsimore do të realizohet sipas VKM 165, date 19.02.2020 nPër caktimin e njësive zbatuese për projektimin, rindërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve arsimore. Bazuar korrespondencave midis Institutit të Ndërtimit, Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë së Rindërtimit, nëpërmjet shkresës nr. 807/1 datë 06.04.2020, është përcaktuar lista e objekteve arsimore të cilët janë demoluar (prishur), janë për tu prishur dhe janë për tu rindërtuar. Objekti nShkolla 9-vjeçare dhe Kopshti Ramazan Jangoziò, e ndodhur në Thumanë, rezulton e demoluar dhe është parashikuar për ndërtim me kapacitet 250 nxënës. - Më datë 16.03.2020 janë hedhur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), kriteret e pjesëmarrjes për lotin 2 nRindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Krujë. Për shkollën nRamazan Jangoziò janë planifikuar 84,064,787 lekë. Mbështetur ngjarjeve dhe rrethanave të sipërcituara, ku shkolla rezultoi e dëmtuar dhe e pashfrytëzueshme me tërmetin e Nëntorit 2019, konstatohet se ky projekt rikonstruksioni ka shkaktuar dëme ekonomike buxhetit të shtetit. - Vlera e projektit të rikonstruksionit të shkollës 40,672,479 lekë pa TVSH (58,892,767 lekë vlera totale - 18,220,288 lekë që i përket palestrës), përbën përdorim pa efektivitet dhe efikasitet të fondeve të buxhetit të shtetit, <u>për shkak të mos studimeve, projekteve të thelluara për përforcimin</u>

	<u>strukturor të shkollës.</u>
Kriteri	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar. VKM nr. 914 datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 37, 38 "Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 34/1 të LPP, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese"
Ndikimi/Efekti	Mos përdorim i fondeve publike me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet
Shkaku	Projekti nuk ka vlerësuar gjendjen strukturore të shkollës
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Nga Bashkia Krujë gjatë zhvillimit të procedurave konkurruese për projektim, të merren masa të zbatohen kushtet dhe standardet teknike të projektimit, ku të vlerësohet saktë aftësia mbajtëse e godinave të vjetra, për të konkluduar nëse godinat e vjetra duhet të përforcohen apo të ndërtohen të reja, në mënyrë që të mos krijohen përdorime pa eficiencë të fondeve publike.

Për sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK A.K dhe projektuesi i objektit ing. Xh.D.

Titulli i Gjetjes Nr. 3	Parregullsi në procedurën e pajisjes me leje së ndërtimi, për rikonstruksion, të objektit “Shkolla 9-vjeçare Thuman”, Bashkia Krujë
Situata:	Për objektin “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë”, është dhënë një leje për kryerje punimesh, i firmosur nga Kryetari i Bashkisë Krujë, z.A.B., jo nëpërmjet sistemit elektronik të aplikimit, në kundërshtim nenin 43, Aplikimi për leje ndërtimi, të Ligjit 107/2014 nëPër planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territoritò ku citohet: "Aplikimi për leje ndërtimi duhet të kryhet përmes sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit".
Kriteri:	Ligji 107/2014 nëPër planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, neni 43.
Ndikimi/Efekti:	Realizimi i punimeve të rikonstruksionit për objektin, pa u pajisur me leje ndërtimit nëpërmjet sistemit elektronik.
Shkaku:	Mosrespektimi i legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Titullari i Bashkisë Krujë, të merren të gjitha masat për pajisjen me leje ndërtimi nëpërmjet sistemit elektronik, për të gjithë rikonstruksionet e objekteve me financim publik, megjithëse janë në inventarin e Bashkisë, sipas përcaktimeve në legjislacionin e planifikimit dhe kontrollit të territoritò.

Në lidhje me këtë, ngarkohet më përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Krujë, z.A. B.

Mbi shërbimin e kolaudimit

Titulli i Gjetjes	Parregullsi në caktimin e kolaudatorit.
--------------------------	--

Nr.4	
Situata	Shoqëria nXh & Mò Shpk, përfaqësuar nga ing. Xh.D., e cila është hartuesja e projektit të zbatuar, rezulton të jetë edhe kolaudatore e realizimit të punimeve të objektit. Ky veprim është në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit Nr.8402 nëPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, ku citohet: <i>Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë.</i>
Kriteri	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 nëPër prokurimin publik, i ndryshuar. Ligjit Nr.8402 nëPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, neni 12
Ndikimi/Efekti	Shkelje e legjislacionit mbi disiplinimin e punimeve, në konflikt interesi
Shkaku	Shoqëria projektuese, nXh & Mò Shpk, kolaudon objektin e vetëprojektuar
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Titullari i Bashkisë Krujë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për caktimin e projektuesit si kolaudator të punimeve dhe për procedurat e prokurimit të punëve publike që do zhvillohen në vazhdimësi, të merren masa për zbatimin e legjislacionit të disiplinimit të punimeve, ku të përcaktohen kolaudatorë që nuk kanë lidhje apo konflikt interesi me projektimin e veprës, me qëllim kontrollin korrekt dhe të painfluencuar të zbatimit të punimeve.

Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. A.B. dhe kolaudatori i punimeve znj. Xh.D.

Mbi llogaritjen e fondit limit

Titulli i Gjetjes Nr.5	Mosargumentim i saktë i fondit limit dhe vendosje emri i produktit (pa cituar “ekuivalent”)
Situata	Llogaritja e fondit limit është bërë nga projektuesi dhe nga auditimi konstatohet se gjatë përgatitjes së Dokumenteve të Tenderit, nuk ka asnjë ndryshim nga ana e Njesisë së Prokurimit. Nga auditimi rezultoi, se 98 zëra pune nga 218 gjithsej, janë të cituara nëanalizë (nuk ndodhen në manualin e çmimeve) dhe në dosje nuk ndodhet asnjë analizë çmimi, në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2, ku cilësohet: “Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.);ose/dhe a. çmimet e tregut; ose/dhe b. çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe ç. çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

	ñAutoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet. <i>Për sa sipër, çmimet e paargumentuara dhe të pa dokumentuara, janë në kundërshtim me legjislacionin e cituar.</i> - Në dy zëra pune (pompa e kaldajës dhe pompa e ngrohjes) është përcaktuar edhe emri (lloji) i materialit (pa cituar ñekuivalent), në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "Për prokurimin publik" neni 23 "Specifikimet teknike", pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, <i>"Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime".</i>
Kriteri	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 ñPër prokurimin publik, i ndryshuar. VKM nr. 629, datë 15.7.2015 ñPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, Ligjit Nr.8402 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit
Ndikimi/Efekti	Mos vlerësim i saktë i vlerës së investimit
Shkaku	Mungesa e analizave të çmimeve dhe argumentime të çmimeve të mallrave
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Titullari i Bashkisë Krujë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përlllogaritjen e fondit limit të paargumentuar teknikisht dhe gjatë zhvillimit të procedurave konkurruese për projektim, të merren masa të zbatohen kushtet dhe standardet teknike të projektimit, ku të përlllogaritet saktë vlera e fondit limit dhe në specifikimet teknike nuk duhet të ketë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët ñose ekuivalent të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK A.B dhe Njësia e Prokurimit me përbërje G.H., E.C. dhe A.G.

Mbi përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit

Nga auditimi i shkresës datë 19.04.2019 të grupit të hartimit e kriterëve të veçanta të kualifikimit, i përbërë nga R.B. dhe G.H. drejtuar NJP, si dhe të Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.

Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 61, pika 2 nëhartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò ku citohet se: *Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyreò. Janë konstatuar shkelje të nenin 46, pika 3 të LPP, kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 "Kontrata për punë publike" pika 5, kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

Titulli i Gjetjes Nr.6	Kërkesat kualifikuese të cilat zvogëlojnë konkurrencën në procedurë.
Situata	Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se Dokumenteve të Tenderit përmbajnë disa parregullsi në shkelje të Ligjit të prokurimit publik. Me shkresën datë 19.04.2019, të grupit të hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, i përbërë nga R.B dhe G.H drejtuar NJP si dhe të Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit të prokurimit publik. Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 61, pika 2 nëhartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò. Janë konstatuar shkelje të nenin 46, pika 3 të LPP, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26. Nga AK kërkohet që OE të disponojë Licenca profesionale të shoqërisë në kundërshtim me VKM 943 datë 28.12.2016 dhe në vendim Nr.42, datë 16.1.2008 nëPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò. Objekti i kontratës është nëRikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestresò, me vlerë të plotë 58,892,767 lekë, ku konstatohet se janë vendosur pika Licencë jo në përputhshmëri me volumin dhe natyrën e objektit. Konstatohen kategorizime më të larta, në krahasim me zërat dhe me volumin e objektit, nga kategoria B (21-50 mil deri në E 201-400 milion). - Nga Ak kërkohet që OE ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diploma dhe të figurojnë në listëpagesa për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, <u>1 (një) mjek të përgjithshëm</u>, ku konstatohet se është përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore. 2.3.7-Kandidati ofertues duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 1 Inxhinier të certifikuar për òPunime ne lartësiò si dhe të paraqesë kontratë pune të

	vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të punimeve, certifikatën përkatëse të lëshuar nga institucionet e autorizuar nga ligji për certifikim, <u>përfshirë në listë pagesën e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit</u>. Vendosja për të paktën 6 muaj në listëpagesë, kufizon konkurrencën duke favorizuar vetëm ata OE të cilët kanë të certifikuar Inxhinier për punime në lartësi mbi 6 muaj. 2.3.8- Kandidati ofertues duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 1 Inxhinier të pajisur me certifikatë Auditor i Sistemit të Menaxhimit të Energjisë dhe të paraqesë kontratën e punës të vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të punimeve, certifikatën përkatëse të lëshuar nga institucionet e autorizuar nga ligji për certifikim, <u>përfshirë në listë pagesën e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit</u>. Nga auditimi i zërave të punimeve, konstatohet se nuk ka asnjë zë në preventiv që të ketë lidhje për shërbim auditim energjie. Gjithashtu objekti ndërtohet dhe zbatohet bazuar specifikimeve teknike të projektit dhe janë të përcaktuara të gjitha parametrat teknikë të pajisjeve. Rrjedhimisht kjo kërkesë është vendosur jashtë objektit të kontratës, ku përsëri kufizohet konkurrenca. Gjithashtu vendosja për të paktën 6 muaj në listëpagesë, kufizon konkurrencën duke favorizuar vetëm ata OE të cilët kanë auditues në sistem energjie mbi 6 muaj. 2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Certifikatë për Ekspert mjedisi dhe të figurojë në listë pagesa, 1 (një) Ekspert mjedisi, e cila është e paargumentuar nga AK dhe e panevojshme. 2.3.11 - Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse, dhe të figurojnë në listë pagesa, <u>7(shtatë) Manovrator</u> . Sasia prej 7 Manovratorësh është jo në përputhje me volume të kontratës, pasi në preventive parashikohet vetëm 120 m³ germim dhe 90 m³ zbarkim. 2.3.12 Kandidati/ofertuesi duhet të ketë të punësuar në stafin e tij gjithashtu një specialist i pajisur me Leje për Ushtrimin e Profesionit të <u>Ekspert Zjarrefikës</u> në listëpagesën e shoqërisë për të paktën paktën <u>6(gjashtë muajt e fundit)</u>. (në rastin e BOE secili prej operatorëve ekonomike duhet të plotësojë këto kriter). Vendosja për të paktën 6 muaj në listëpagesë, kufizon konkurrencën duke favorizuar vetëm ata OE të cilët kanë të ekspert zjarrefikës mbi 6 muaj. Gjithashtu, vendosja e kriterit se në rastin e BOE secili prej operatorëve ekonomikë duhet të plotësojë këto kriter është i padrejtë dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 në Përmirësimin e rregullave të prokurimit publik, neni 74 pika 3 ku citohet<i>secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DT. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje.</i> Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme zvogëlon konkurrencën, pasi një operator, i cili nuk disponon <u>Ekspert Zjarrefikës</u> nuk mund të kryejë bashkim operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh, pra përjashtohen OE duke i mohuar
--	--

	mundësinë e bashkimit. 2.3.14/2. Personeli dhe fuqia punëtore AK kërkon që Kandidati/ofertues duhet të vërtetojë se disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës dhe për të provuar këtë kusht duhet të ketë një punësim mesatar për periudhën Mars 2018 - Mars 2019 i të paktën 200 (dyqind) personave, duke përfshirë stafin e përhershëm. Numri i personave dhe periudha Mars 2018 - Mars 2019, <i>nuk është argumentuar nga NJP vendosja e tyre, në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës.</i> Numri i lartë i punonjësve të operatorëve ekonomik, menjëherë kufizon konkurrencën, pasi shumë pak Operatorë Ekonomikë në sektorin e ndërtimit, disponojnë numër kaq të lartë punonjësish. Pra, menjëherë AK, indirekt vështirëson pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, duke drejtuar ofertuesit drejt bashkimit të operatorëve ekonomik, me qëllim arritjen e numrit të punonjësve. -Në pikën 2.3.16 të DT kërkohet Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, ku, konstatohen kërkesa kualifikuese jo në përputhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës. Janë kërkuar mjete si vinca 11 vinca, freza, cekic hidraulik, Rul, Autovinc, Autobetoniere, Autopompe betoni, Nyje prodhim betoni, Nyje inertesh, sasi e madhe kamionash etj, në mënyrë të pajustificuar e të paargumentuar. Pra, vendosen kërkesa jo në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës, duke e vendosur si kriter kualifikues lejen mjedisore të fabrisës së betonit. Në pikën g, kërkohet Licencë për transport mallrash për te trete dhe me brenda vendit në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës me një afat 5-vje nga data e leshimit të Licencës. Kërkesa nga AK përbën diskriminim dhe trajtohet jo të barabartë për të gjithë OE që e kanë afatin më pak se 5 vite, <u><i>kur afati i zbatimit të punimeve është vetëm 3 Muaj.</i></u> Në pikën 2.3.18 kërkohet të organizohet një vizite në kantier datë 13.05.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët ekonomike të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizite. Të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në procedurë duhet të paraqiten në kantier për të cilën do të pajisen me vertetim nga Bashkia Krujë, <u><i>mosparaqitja e këtij vertetimi është kusht skualifikues.</i></u> Kërkesa e mësipërme, si kusht skualifikues, nuk gjen asnjë mbështetje ligjore bazuar në rregullat të prokurimit publik. Nuk tregohet arsyeja se pse OE, që nuk kanë asnjë nevojë për vizitën në kantier, pasi e kanë të qartë objektin ku do të ndërhyhet dhe mënyrën e financimit sipas kushteve nga burimi i financimit, e cila është e shkruar edhe në Urdhrin e Prokurimit, duhet të skualifikohen. Nuk është e argumentuar nga AK gjithashtu, se pse OE, kandidatë për pjesëmarrje, duhet të konfirmojnë paraprakisht me shkrim synimin e tyre për të marrë pjesë në këtë vizitë. <u><i>Me vënien e këtij kriteri si skualifikues, zbulohet edhe interesimi i OE që do të marrin pjesë në procedurë dhe krijohet mundësia e një marrëveshje të fshehtë bashkëpunimi midis aktorëve pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. Kushti skualifikues i mosparaqitjes në vizitë në kantier është kusht</i></u>
--	---

	<u>diskriminues, i cili nuk mbështet në asnjë bazë ligjore.</u> Kriteri i mësipërm, i vendosur nga AK <u>si skualifikues</u>, është i paargumentuar teknikisht dhe tregon qartë se, zbulohen kandidatët e interesuar për të marrë pjesë në garë, duke krijuar mundësinë e marrëveshjes ndërmjet kandidatëve për konkurrentë, të cilat janë të ndaluara me Ligjin nr. 9121, datë 27.07.2003 nëPër mbrojtjen e konkurrencës, neni 4, pika 1.a, sipas të cilës <i>“Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që:</i> <i>a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi...</i> Më datë 10.05.2019 protokolluar në Bashkinë Krujë nr. 3437 datë 10.05.2019, konfirmon pjesëmarrjen vetëm operatori ekonomik “E”shpk. Me vertetimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 3437/1 prot datë 15.05.2019, lëshohet vërtetimi se subjekti nëEòshpk, ka kyer vizitën në objekt. <i>Nisur nga fakti që hapja e tenderit është bërë në datën 23.05.2020, tregon që fituesi është paracaktuar që në ditën e “vizitës në kantier”, pra pa u mbyllur afati I dorëzimit të dokumenteve, gjë që tregon që OE fitues ka patur mundësinë që ofertën ekonomike ta bënte në vlerë afër fondit limit (siç edhe e ka bërë në fakt, 99.82% e fondit limit).</i> Në pikën 2.3.19 nga Ak kërkohet që Kandidati/ofertuesi duhet te paraqesë Certifikatat e Standardizimit të cilat nuk kanë lidhje me natyrën e objektit.
Kriteri	Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar. VKM nr. 914 datë 29.12.2014, nenin 46, pika 3 të LPP, kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik. Sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 26 "Kontrata për punë publike" pika 5, kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha 5 kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
Ndikimi/Efekti	Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit duke favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.
Shkaku	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 nëPër prokurimin publikò i ndryshuar
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Bashkia Kruja, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i vendosur të jetë në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, për të nxitur konkurrencën dhe për të mos favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar, duke dhënë argumente për secilin kriter me procesverbal, i cili të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

Për veprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi grupi i hartimit të kriterëve kualifikuese R.B dhe G.H.

Titulli i Gjetjes Nr.7	Mosvlerësim i saktë i ofertave.
Situata	Sipas procesverbalit të KVO datë 27.05.2019 dhe bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta kualifikuese konstaton se kompania " BOE në SHPK & në SHPK & "S" në SHPK " shpk është identifikuar si oferta e suksesshme dhe ankesa nuk ka patur. Me raportin përmbledhës nr. 4043 datë 05.06.2019, miratohet procedura nga titullari i AK. Kontrata nënshkruhet me nr. 4290 datë 13.06.2019 midis BOE në SHPK & në SHPK & "S" SHPK me përfaqësues kompaninë në SHPK i përfaqësuar nga z. I.M dhe Bashkisë Krujë me përfaqësues z. A.B. Nga verifikimi në SPE të dokumenteve të paraqitura nga BOE fitues, rezultoi se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 15.06.2019, OE në SHPK është kontraktori kryesor dhe merr përsipër 70 % të punimeve. Për pasojë në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në miratimin e rregullave të prokurimit publik, nën 74 pika 3 ku citohet <i>secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DT. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje</i> , OE në SHPK duhet të kishte mesatarisht për periudhën e kërkuar 140 punonjës (70% e 200 punonjësve të kërkuar), ndërkohë që ka mesatarisht 122 punonjës, për këtë arsye, BOE fitues duhet skualifikuar dhe tenderi duhet anuluar.
Kriteri	Ligji nr. 9643, datë 20/11/2006 në prokurimin publik, i ndryshuar. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Është shkaktuar përdorim i fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore të prokurimit, në vlerën totale të kontratës.
Shkaku	Mos vlerësim i saktë i OE fitues
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Krujë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve dhe të marrë masa për eliminimin e shpalljes fitues të operatorëve ekonomikë me mangësi në plotësimin e kriterëve kualifikuese, në prokurimet për punë publike, mallra/shërbime me shkelje ligjore, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës

Përsa sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO-së F.C kryetar, I. H anëtar dhe S.P anëtar.

2.2 PROCEDURA E PRISHJES SË OBJEKTIT DHE ZBATIMI I PUNIMEVE TË KONTRATËS

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit dhe projektprventivi i azhurnuar,
2. Situacion përfundimtar,
3. libri i masave,
4. kontrata për punë civile.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë”, Bashkia Krujë.				
14.Lidhja e kontratës Nr. 4290 prot datë 13.06.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 70,785,179 lekë BOE fitues “E” SHPK & “R” SHPK & “S” SHPK , përfaqësuar nga z.I.M.		16.Likuiduar 27,208,458 lekë me TVSH, shuma e pa likuiduar 43, 333,757 lekë me tvsh.	
17- Situacioni Përfundimtar dt 20.09.2018 -Vlera me tvsh 70,541,741 lekë -Vlera pa tvsh 58,784,784 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 3 muaj. Fillimi punimeve: 13.06.2019 Përfundimi punimeve : 13.09.2019		19. Zgjatja e kontratës	
20. Mbikëqyrësi i punimeve E, përfaqësuar nga z.G.I.	Licenca Nr: MK 1015/10	Kontrata nr. prot, datë ./06.2019		
21. Kolaudatori i punimeve "XH & M" SHPK, Përfaqësuar nga znj.Xh.D.	Licenca Nr: MK 1322/7	Kontratë nr. 6189 prot, datë 23.09.2019		
22.Akt Kolaudimi Datë 10.10.2019	23.Akt i marrjes së përkohshme në dorëzim dt 10.10.2019			

A) Mbi procedurën e prishjes së objektit

Ky objekt është realizuar në zbatim të kontratës nr. 4290, datë 13.06.2019 ndërmjet AK Bashkisë Krujë përfaqësuar nga titullati z. A.B. dhe BOE në SHPK & R SHPK & S SHPK, përfaqësuar nga z. I.M..

Punimet kanë filluar në datën 13.06.2019 dhe kanë përfunduar në datën 13.09.2019.

Objekti dy kate i shkollës 9-vjeçare, Thumanë, mbasi janë konstatuar dëmtime strukturore të tij, për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019, është prishur në datë 04.12.2019, ku është mbajtur dhe procesverbali i prishjes Nr.7865, datë 10.12.2019, nënshkruar nga S. Sh., Kryeinspektori i IMTV-së Bashkia Krujë, R.T., përfaqësues i IKMT dhe I. Dh., përfaqësues i Policisë së Shtetit. Për këtë objekt kishte dalë Vendimi i Shembjes Nr.241 datë 02.12.2020, i firmosur nga Kryeinspektori i IMTV të Bashkisë Krujë, z.S. Sh., ku citohen arsyet e prishjes: “Në bazë të procesverbalit 30.11.2020 të mbajtur nga grupi i punës i ngritur me urdhër Nr.753/1 datë 26.11.2019 të Kryetarit të Bashkisë, në objektet të tipit Shkollë 9-vjeçare 2K me numër pasurie 113/4 në Nj. Administrative Thumanë me adresë Qendër Thumanë, pranë Shkollës së Mesme Thumanë. U konstatua se objekti i mësipërm është rrënuar në pjesën më të madhe të strukturës dhe si pasojë përbën problematikë për jetën e njerëzve. Të parashikuara nga kushtet e emergjencës së krijuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”.

Titulli i Gjetjes Nr.8	Parregullsi në procedurën e prishjes së objektit “Shkolla 9-vjeçare Thumanë”, Bashkia Krujë
Situata:	Nga auditimi i dokumenteve të paraqitura, rezultoi se vendimi i prishjes së "Shkollës 9-vjeçare Thumanë", është në tejkalim të kompetencave të Kryeinspektorit të IMTV-së, sepse objekti në fjalë nuk ishte i jashtëligjshëm dhe për pasojë nuk është subjekt i Nenit 5, pika d, i Ligjit Nr. 9780 datë 16.07.2007 nëpër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga

	ndërtimet e kundraligjshme, i ndryshuarò, i cili trajton objektet e jashtëligjshme. Objekti përpara se të prishej, duhet të ishte pajisur me ñLeje për prishje ndërtimiò, tagër e titullarit të Bashkisë Krujë, në Nenin 39, pika 1, të Ligjit 107/2014 ñPër planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territoritò, sipas të cilit ñLeja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji” dhe Nenin 11, pika ç, të VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò.
Kriteri:	Ligji 107/2014 ñPër planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territoritò. Ligji Nr. 9780 datë 16.07.2007 ñPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme, i ndryshuarò
Ndikimi/Efekti:	Prishja e shkollës pa respektuar procedurat ligjore, për prishjen e objekteve të cilat nuk janë objekte të jashtëligjshëm.
Shkaku:	Mosrespektimi i legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe kontrollin e territorit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Titullari i Bashkisë Krujë, në rastet e prishjes së objekteve të dëmtuar nga tërmeti ose jo, të cilët nuk janë objekte të paligjshme, të merren masa për nxjerrjen paraprakisht të ñLejes për prishje ndërtimiò, sipas përcaktimeve në legjislacionin e planifikimit dhe kontrollit të territorit.

Nga sa sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. S. Sh., me detyrë Kryeinspektor i IMTV-së Bashkia Krujë, për tejkalim të kompetencave të dhëna nga Ligji Nr. 9780 datë 16.07.2007 ñPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme, i ndryshuarò dhe titullari i AK z. A.B., Kryetar i Bashkisë Krujë, për mosushtimin e kompetencave të përcaktuara me ligjin Nr. 107/2014 ñPër planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territoritò dhe aktet nënligjore, në lidhje me lejet e prishjeve të objekteve.

Përveç procesverbalit dhe vendimit të prishjes, dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga Bashkia Krujë, në lidhje me realizimin e prishjes së objekti është si vijon:

-Vendim i Këshillit Bashkiak Krujë, Nr. 82 datë 28.11.2019, ku është vendosur shembja e të gjithë ndërtesave, pallate ose objekte private, të konstatuara si të pa banueshme sipas akt konstatimeve të organeve kompetente.

- Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë Nr.82 datë 28.11.2019 nga Prefektura, me shkresën nr. 1104/1, datë 30.11.2019.

- Akt konstatim të datës 30.11.2019 i grupit të konstatimit të objektit të dëmtuar pas tërmetit të datës 26.11.2019. Nga verifikimi i këtij Akt konstatimi, është e pamundur të identifikohen me emra personat që kanë qenë pjesë e grupit të inspektimit, megjithëse nga punonjësit e bashkisë pretendohet që kanë qenë inxhinierë nga grupi grek i emergjencave civile.

- Kërkesë për mbështetje IKMT për prishje me nr.7720 datë 28.11.2019.

- Disa foto të objektit përpara prishjes dhe mbas prishjes.

-Akt-konstatim Nr.01 datë 03.12.2019, i mbajtur nga grupi i inspektimit, i përbërë nga z.G.I. dhe znj. Xh.D., përkatësisht mbikëqyrës dhe kolaudator i kontratës për ñRikonstrukcionin e shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanëò dhe z. A.I., inxhinier.

Titulli i Gjetjes Nr.9	Parregullsi në procedurën e prishjes së objektit “Shkolla 9-vjeçare Thumanë”, Bashkia Krujë.
Situata:	Nga shqyrtimi i Akt-konstatimit të datës 30.11.2019 i mbajtur nga grupi i konstatimit të gjendjes së objektit në Rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë të dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019, ku objekti është evidentuar si i pa banueshëm, është e pamundur të identifikohen emrat e personave që kanë qenë pjesë e grupit të inspektimit (megjithëse nga punonjësit e bashkisë pretendohet që kanë qenë inxhinierë nga grupi grek i emergjencave civile) dhe rekomandimet në lidhje me këtë objekt. Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Bashkia Krujë, nuk evidentohet asnjë urdhër për ngritjen e një grupi ekspertësh për vlerësimin e këtij objekti. Në Akt-konstatimin Nr.01, datë 03.12.2019, të mbajtur nga grupi i inspektimit i përbërë nga z. G.I. dhe znj. Xh.D., përkatësisht mbikëqyrës dhe kolaudator i kontratës për Rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë dhe z. A.I., inxhinier, objekti është konsideruar i pabanueshëm, dëmet në objekt janë cilësuar të larta dhe është rekomanduar që të priset. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Bashkia Krujë, nuk evidentohet se me çfarë tagri grupi i inspektimit ka kryer akt-konstatim për këtë objekt, pa patur urdhër ose detyrë të ngarkuar nga Bashkia Krujë, apo nga ndonjë institucion tjetër shtetëror. Këto veprime janë në kundërshtim me Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 nëPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, neni 34 dhe VKM nr. 26, datë 15.01.2020 nëPër kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara.
Kriteri:	Akti Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 nëPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore VKM nr. 26, datë 15.01.2020 nëPër kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara.
Ndikimi/Efekti:	Mbajtja e akt konstatimeve për prishjen e shkollës pa respektuar procedurat ligjore, vendimin e Këshillit Bashkiak Krujë dhe vendimin e Kryetarit të Bashkisë Krujë, për grupet të cilat do të kryejnë akt konstatimet e objekteve të dëmtuar.
Shkaku:	Mosrespektimi i Vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë dhe vendimit të Kryetarit të Bashkisë Krujë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Titullari i Bashkisë Krujë, të merren masa që në vazhdimësi, vlerësimi teknik i objekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 të bëhen nga persona apo grupe teknike të autorizuar dhe prishjet e ndërtimeve të rezultuara si të dëmtuara nga tërmeti, të realizohen sipas legjislacionit në fuqi.

Në lidhje me sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi G.I., Xh.D. dhe A.I., si dhe zyrtarët e Bashkisë Krujë që kanë marrë në konsideratë një aktkonstatim nga persona të paautorizuar.

C) Realizimi i punimeve të kontratës

Sipas dokumentacionit të administruar në dosje, punimet kanë filluar në datë 13.06.2019 dhe kanë përfunduar në datë 13.09.2019. Në datë 14.09.2019 është mbajtur procesverbal i ndryshimit të punimeve, i firmosur vetëm nga sipërmarrësi. Miratimi i kërkesës për preventiv të rishikuar është bërë në datë 14.09.2019, nga Kryetari i Bashkisë. Preventivi i ripunuar është firmosur nga Kryetari i Bashkisë, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi. Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur në datë 10.09.2019 (i pa firmosur nga Kryetari i Bashkisë). Procesverbali i kolaudit është mbajtur në datë 10.10.2019. Akti marrjes së përkohshme në dorëzim është kryer në datë 05.11.2019, i sigluar nga G.I., mbikëqyrës, I.M., përfaqësues i sipërmarrësit, E shpk, Xh.D, kolaudatore dhe përfaqësuesit e Bashkisë Krujë, I.K., E.S., S.K. dhe A.B..

- Nga verifikimi në terren konstatohet se mungojnë zëra dhe pajisje të cilat nuk kanë qenë brenda objektit të dëmtuar nga tërmeti dhe që kishte mundësi për t'u ruajtur, magazinuar, inventarizuar dhe ripërdorur apo nxjerrë në ankand (Aneksi 1).

Titulli i Gjetjes Nr. 10	Asgjësimi i aktiveve pa ndjekur procedurat administrative.
Situata	Nga verifikimi i projekt-preventivit, situacionit përfundimtar dhe verifikimi në terren për prishjen e objektit, konstatohet se ka materiale, të cilat nuk janë prekur nga shembja e objektit, pasi kanë qenë zëra dhe pajisje jashtë objektit. Zërat e punimeve nëZgara dekorative hekuri me figuracion mesatar në rrethimin e shkollës, nëPortë dekorative rrëshqitëse, nëPemë dekorative, nëStola druri dhe rezervuar i lëndës djegëse (sipas Aneksit nr. 1), të cilat nuk janë prekur nga prishja e objekti (pasi janë vendosur jashtë objektit), në total kanë vlerën prej 5,627,178 lekë pa TVSH . Konstatohet se nga AK nuk janë marrë masa për kontabilizimin, dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve të cilat nuk ishin prekur nga tërmeti. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 " <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik</i> ", pika 108, ku citohet se <i>„Aktivet afatgjata që konsiderohen të panevojshme për njësinë në një periudhë të mëvonshme të funksionimit të saj (në rast mbylljeje/shkrirjeje të njësisë, ndryshimi të misionit apo objektivave afatgjate të njësisë), por që mbeten në gjendje përdorimi mund të jepen në rend shterues (nga a në b). a. transferohen pa pagese në një njësi tjetër publike brenda sektorit të qeverisjes së përgjithshme. Konfirmimi zyrtar nga njësia përfituese vërteton përfundimin e transaksionit; b. shiten në formën e ankandit publik</i> ”.
Kriteri	Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 " <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik</i> ",
Ndikimi/Efekti	Vlera e aktiveve të demoluara e pa riadministruar (përdorim/tjetërsimin).
Shkaku	Mosmarrja e masave për riadministrimin e aktiveve të paprekura nga demolimi
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Titullari i Bashkisë Krujë, të marrë masa nëpërmjet një grupi pune, për të nxjerrë përgjegjësitë për mosveprimin në lidhje me kontabilizimin apo përdorim/tjetërsimin e aktiveve dhe materialeve të paprekura nga prishja e godinës së shkollës në Thumanë dhe të ndjekë të gjitha procedurat për riadministrimin e këtyre aktiveve, apo arkëtimin e vlerës së tyre prej

	5,627,178 lekë pa TVSH nga personat përgjegjës.
--	---

Në lidhje me këtë ngarkohet me përgjegjësi titullari i Bashkisë, z.A.B..

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor (në zërat e punime të evidentuara në Aneksin nr. 2), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,477,573 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes Nr.11	Dëm ekonomik në zbatimin e kontratës për objektin “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë”, Bashkia Krujë
Situata:	Në objektin “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 1,477,573 lekë pa tvsh (Sipas Aneksit nr. 2). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 4290 prot datë 13.06.2019, të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Krujë dhe BOE fitues në SHPK & në SHPK & “S” SHPK.
Kriteri:	Ligji Nr. 8402 date 10.9.1998 nëpër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve, i ndryshuar. Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 nëpër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit. Kontrata për zbatimin e punimeve midis Bashkisë Krujë dhe sipërmarrësit BOE.
Ndikimi/Efekti:	Mosrealizimi i punimeve sipas punimeve të preventivit të parashikuara në projekt.
Shkaku:	Diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 1,477,573 lekë pa tvsh.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Bashkia Krujë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,477,573 lekë pa tvsh nga BOE fitues në SHPK & në SHPK & “S” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën Nr. 4290 prot., datë 13.06.2019, me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë”, Bashkia Krujë”, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** z. G.I nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

2) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot, datë __.06.2019

- Nga ana e kolaudatorit të punimeve Xh.D nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t’i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

2) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

...

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

3) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr 6189 prot, datë 23.09.2019.

Në lidhje me sa sipër, në observacionin e dërguar nga Bashkia Krujë me nr. 6878/4 prot., datë 26.01.2021, të protokolluara në KLSH me nr. 1028/4 prot. datë 27.01.2021, në Konfirmim Projekt Raporti i Auditimit, është cituar si më poshtë:

Pretendimi i subjektit të auditimit:

-Grupi i punës i ngritur me autorizimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 7741/1, datë 03.12.2019, i përbërë nga I.Xh., Drejtor i shkollës 9-vjeçare Thumanë, S.K, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve NJA Thumanë, I.K., Arkitekt DPKZHT dhe V.U., Sekretare e shkollës 9-vjeçare Thumanë, me procesverbalin datë 04.12.2019, kanë marrë në administrim dhe ruajtje, materialet dhe pajisjet me vlerë 6,752,614 lekë me TVSH.

Nga verifikimi, rezulton se materialet dhe pajisjet e mësipërme janë të vendosura në territorin e shkollës 9-vjeçare Thumanë dhe janë në ruajtje dhe administrim nga z. I.Xh., Drejtor i shkollës 9-vjeçare Thumanë.

Sa më sipër, kërkojmë nga ana Juaj, që të merren në konsideratë gjatë hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për të mos u përfshirë vlera prej 6,752,614 lekë.

Ju sigurojmë se me ardhjen e Raportit Përfundimtar të Auditimit do të hartohet Plani i Veprimit nëMbi zbatimin e rekomandimeve, si dhe do të programohen masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve në afatet e përcaktuara dhe në përputhje me kërkesat ligjore e nënligjore në fuqi. Bashkëlidhur, procesverbali datë 04.12.2019.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Përsa i përket argumenteve të sjella nga Bashkia Krujë, në lidhje me pajisjet dhe zërat e punës, të cilat nga grupi i auditimit janë cilësuar si të mundshme për tu riadministruar, Grupi i auditimit sqaron se, në observacionin e ardhur nga Bashkia Krujë për akt-konstatimin, me shkresën përcjellëse të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë z. A.B., me nr. 6878/2 prot., datë 10.11.2020, citohet që: *“Nga infomacioni i dhënë nga Drejtori i kësaj shkolle rezulton se pranë shkollës 9 vjeçare Thumanë, ndodhen materialet dhe pajisjet si vijon: Pemë dekorative; Portë dekorative; Zgara dekorative, etj, të cilat i kemi në proces dokumentimi.*

-Në situatën e krijuar ditët e para pas tërmetit të datës 26.11.2020, ku siç u konstatua, konstruksioni i objektit kishte dëmtime të rënda dhe të pakthyeshme dhe për rrjedhojë u mor

vendimi për prishjen e menjëhershme me qëllim shmangien e rrezikut për jetën dhe shëndetin e banorëve përreth. Procesi i kërkim - shpëtimit në godinat e shembura të cilat ndodheshin shumë afër shkollës së demoluar, ka vijuar për ditë të tëra dhe prezenca e banorëve, ekipeve të ndryshme dhe vullnetarëve, me makineri të rënda që i erdhën në ndihmë ekipeve të kërkim shpëtimit, të cilat kanë sjellë si pasojë të dëmtohen materialet dhe pajisjet e këtij objekti.

-Në këto kushte ka qenë e pa mundur për t'i ruajtur dhe shpëtuar një pjesë të materialeve të këtij objekti, përfshi rezervuarin e furnizimit me lëndë djegëse i cila ka qenë brenda objektit.

Siç shihet, argumentet e sjella në dy shkresa të ndryshme, të hartuara nga i njëjti institucion dhe për të njëjtën problematikë, janë të kundërta. Bashkëlidhur observacionit duhet të kishte dokumentacion shoqërues që do të tregonte magazinimin e përkohshëm të këtyre materialeve.

Përsa sipër, pretendimi i ardhur nëpërmjet observacionit, nuk merret në konsideratë.

Në përfundim, nën gjykimin e pavarur të grupit të auditimit, vlerësojmë se, në kushtet kur procedurat e ndjekura për prishjen e objektit "Shkolla 9-vjeçare, Thumanë", e dëmtuar nga tërmeti, janë kryer në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, dhe si pasojë edhe dokumentet – produkt i këtyre procedurave (akt konstatimet), nuk janë në përputhje me Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" dhe VKM nr. 26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara". Procesi i vendimmarrjes, veçanërisht për prishjen e detyruar të objekteve, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme, i ndryshuar", neni 5, pika d dhe mbart riskun që njëkohësisht të jetë edhe i gabuar. Ndërsa për procedurat e ndjekura për prokurimin, nën gjykimin e pavarur të grupit të auditimit, vlerësohet se kriteret kualifikuese kanë zvogëluar konkurrencën në prokurim, duke favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

2. Mbi programin e ushtruar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe zhvillimin e zonave të prekura nga tërmeti "Rindërtimi objekteve arsimore" "Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare Ramazan Jangozi.

Në zbatim të autorizimit nr 1028 prot., datë 13.10.2020 u shqyrtua dokumentacioni i Lotit 2 me objekt "Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Krujë", konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Krujë"		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit "I kufizuar, marrëveshje kuadërò Urdhri nr 16 datë 1.03.2020 REF-54452-03-16-2020	2 Njësia e Prokurimit E.K. R.Gj. M.Xh	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr 16/2 datë 10.03.2020 E.O D.M B.H.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 161,878,465 leke pa tvsh Loti II (për dy shkolla)	5. Ofertat fituese (pa tvsh) 22 kompani të kualifikuara për marrëveshjen kuadër	5.1. Oferta fituese e 2 shkollave 152,165,757 lekë
		5.2. Diferenca nga fondi limit 9,712,708 lekë
6/1 Data e hapjes së tenderit Data 03.04.2020	7. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	8. Kontrata Nr. 837 prot. 17.04.2020
6/2 Kohezgjatja e kontrates, 5 muaj		

A. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Rindërtimi i objekteve arsimore do të realizohet sipas VKM Nr. 165, date 19.02.2020 nëpërmjet caktimit të njësisë zbatuese për projektimin, rindërtimin dhe rikonstrukcionin e objekteve arsimore.

- Me kërkesën e Drejtorit të Departamentit të Menaxhimit të Projekteve E.O. datë 11.03.2020, kërkohet fillimi i procedurës së prokurimit në kuadrin e rindërtimit për objektet arsimore. Bazuar korrespondencave midis Institutit të Ndërtimit, Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë së Rindërtimit, nëpërmjet shkresës nr. 807/1 datë 06.04.2020, është përcaktuar lista e objekteve arsimore të cilët janë demoluar (prishur), janë për tu prishur dhe janë për tu rindërtuar. Objekti në Shkollën 9-vjecare dhe Kopshti Ramazan Jangozi, e ndodhur në Thumanë, rezulton i demoluar dhe është parashikuar për ndërtim me kapacitet 250 nxënës.

Në Bashkinë Krujë objektet e identifikuar janë si më poshtë:

1. Shkolla 9-vjecare Larush Hajdar Hoxha, 2. Kopshti Varosh, 3. Shkolla 9-vjecare Mukje, 4. Shkolla e mesme e bashkuar Selman Daci, 5. Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Ramazan Jangozi, 6. Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Kastrioti Derven, 7. Shkolla 9-vjecare Gjon Luka Luz me sipërfaqe totale ndërtimi të të gjitha objekteve afërsisht 10,691 m².

- Me vendimin nr. 10 datë 07.04.2020 të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit është miratuar lista e përditësuar e objekteve arsimore, për rindërtim sipas oponentit dhe miratimit të Institutit të Ndërtimit. Për objektet arsimore të ndodhura në njësitë territoriale të Bashkive Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Kamëz, Vorë, Shijak, Krujë, Kurbin dhe Lezhë. Në listën e Bashkisë Krujë ndodhet dhe objekti në Shkollën 9-vjecare dhe Kopshti Ramazan Jangozi.

b. Llogaritja e fondit limit.

Llogaritja e fondit limit është në sipërfaqen e ndërtimit të shkollës (1,867 m²) me koston e ndërtimit prej 45,027 lekë, ku vetëm për shkollën në Ramazan Jangozi janë planifikuar 84,064,787 lekë dhe për të dy shkollat rezulton vlera prej 161,878,465 lekë pa TVSH.

c. Kërkesat e kualifikimit

- Me urdhrin e prokurimit të titullarit të FSHZH, urdhërohet të kryhet prokurimi i përsheptuar kuadër të procesit të rindërtimit me objekt "Rindërtimi i objekteve arsimore në zonat e prekura nga tërmeti", në mbështetje të **nenit 42** të Aktit normativ nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, nenin 13 të ligjit nr. 10130, datë 11.05.2019 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar. Ngarkohet njësi e prokurimit e përbërë nga E.K., R.Gj. dhe M.Xh., të cilët do të hartojnë kriteret e veçanta të pranimit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional. Komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga E.O., D.M., B.H..

Me procesverbalin nr.1 datë 12.03.2020, hartohen kërkesat kualifikuese për të gjithë LOTET.

Kriteri përzgjedhjes së fituesit (Faza e dytë) përbëhet:

Kriteret e Vlerësimit

- | | |
|---|---------------|
| (i) Çmimi më i ulët | [0 i 60 Pikë] |
| (ii) Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit | [0 i 30 Pikë] |
| (iii) Cilësia | [0 i 10 Pikë] |

Titulli i Gjetjes Nr.12	Kërkesat kualifikuese të cilat nuk kanë nxitur konkurrencën në procedurë.
Situata	Më datë 16.03.2020 janë hedhur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE),

	kriteret e pjesëmarrjes për lotin 2 në Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Krujë, ku për dy objekte në Rindërtimi i objekteve dy kate mbi tokë të Shkollës 9-vjeçare në Kastrioti dhe kopshti, Derveni dhe Shkolla 9-vjeçare Ramazan Jangozi dhe Kopshtin dy kate mbi tokë, rezultojnë vlera prej 161,878,465 lekë pa TVSH. Vetëm për shkollën në Ramazan Jangozi janë planifikuar 84,064,787 lekë pa TVSH. Në pikën 2.3.4 nga AK kërkohet që stafi kryesor i inxhinierëve të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit është: Shoqëria të ketë në stafin drejtues të punësuar dhe të regjistruar: 1 (një) Drejtues Projekti (Inxhinier Ndërtimi) me 15 vite eksperience pune në Ndërtim Civil, 6 (gjashtë) Inxhinier ndërtimi me 10 vite eksperience pune në Ndërtim Civil, 2 (dy) Arkitektë me 10 vite eksperience pune në Ndërtim Civil, 2 (dy) Inxhinier Konstruktorë me 10 vite eksperience pune në Ndërtim Civil, 2 (dy) Inxhinier Mekanikë me 10 vite eksperience pune 2 (dy) Inxhinier hidroteknikë me 5 vite eksperience pune, 2 (dy) Inxhinier gjeodetë me 5 vite eksperience pune, 2 (një) Inxhinier elektrikë me 5 vite eksperience pune, 2 (dy) Inspektore Cilësie me background Inxhinierik me 5 vite eksperience pune si Inspektor Cilësie, 2 (dy) specialiste të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE) me min 2 vite eksperience pune, 1 (një) Inxhinier mjedisi me 5 vite eksperience pune. Nga njësia e prokurimit ky kriter është argumentuar lidhur me numrin e objekteve dhe vendndodhjes së tyre. Përcaktimi i viteve të eksperiencës në punë argumentohet si tregues i aftësive profesionale, organizative, reputacionit dhe besueshmërisë që ndikon në efikasitetin e kontratës. Referuar nenit 46, pika 3 të LPP, <i>kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik</i>, ku gjykohet qartë se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Kërkesa e mësipërme për eksperiencën e punës të inxhinierëve është e pa nevojshme dhe e paaplikueshme, sepse eksperiencia e punës së stafit teknik të një operatorit ekonomik që operon në sektorin e ndërtimit, rregullohet nga "Vendimi Nr.42, Datë 16.1.2008 në Përmirësimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Gjithashtu AK duhet të përcaktojë saktë në qoftë se togfjalëshi "Staf teknik" nënkupton drejtues teknik sipas VKM Nr.42 Datë 16.1.2008 të sipërpërmendur, apo thjesht staf i kompanisë, i cili është pjesë vetëm e listës pagesave të shoqërisë dhe jo licencës së shoqërisë. Gjithashtu nuk është argumentuar numri i inxhinierëve të ndërtimit, apo inxhinierëve të tjerë dhe vjetërsia prej 15, 10, 5 dhe 2 vite eksperiencë. Në pikën 2.3.5 nga AK kërkohet që fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht 260 punonjës të punësuar (sipas shtojcës 1) për periudhën Nëntor 2019 i Janar
--	---

	2020. Numri i personave dhe periudha Nëntor 2019 – Janar 2020, nuk është argumentuar saktë nga NJP vendosja e tyre, në përputhje me natyrën. Sasia e kërkuar e numrit të punonjësve të operatorëve ekonomik, ngushton konkurrencën, pasi shumë pak Operatorë Ekonomikë në sektorin e ndërtimit, në Republikën e Shqipërisë, nuk disponojnë numër kaq të lartë punonjësish. Pra, indirekt vështirësohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë, duke drejtuar ofertuesit drejt bashkimit të operatorëve ekonomikë, me qëllim arritjen e numrit të punonjësve. Sa më sipër konstatohet mospajtueshmëri e plotë me Neni 41 të Aktit normativ nr. 9 datë 16.12.2019 " <i>Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore</i> " në Parimet e prokurimit publik për rindërtimin pika b 1. Prokurimi publik për rindërtimin siguron nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.
Kriteri	Aktit normativ nr. 9 datë 16.12.2019 " <i>Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore</i> ", Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 në Prokurimin publik, i ndryshuar. VKM nr. 914 datë 29.12.2014, nenin 46, pika 3 të LPP, kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.
Ndikimi/Efekti	Mos stimulim të operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit
Shkaku	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri të plotë me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 në Prokurimin publik i ndryshuar
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Titullari i Fondit Shqiptar të Zhvillimi, të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë përvendosje e kriterëve në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve dhe në procedurat e prokurimit të punëve publike që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret kualifikuese të hartohen në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, ku çdo kriter duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Përsa sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga E.K., R.Gj dhe M.Xh.

- Në DST përcaktohet Metodologjia që do të aplikohet nga autoriteti përgjegjës në fazën e dytë: Në rast se operatori ekonomik renditet i pari në më shumë se një lot, atëherë atij operatori ekonomik do t'i jepet loti ku vlera e ofertës së tij është ulja me e favorshme ekonomike për autoritetin përgjegjës në kombinimin e mundshëm të të gjitha loteve.

Lotet e tjera do t'i jepen operatorit ekonomik që renditet i dyti, i treti e në vijim, në çdo rast duke pasur parasysh kombinimin më të dobishëm nga pikëpamja e kostos për autoritetin përgjegjës për të gjitha lotet, sikurse më lart referuar.

Në rast dhe/ose gjatë fazave të tjera të hapjes së minikonkursit sipas loteve, operatori/ët palë në marrëveshje kuadër, do të plotësojë/në një vetëdeklarim që ka/kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim/investime, në kuadër të rindërtimit, i cili në momentin e hapjes së minikonkursit i ka/kanë përfunduar punimet fizike, në masën 40 % të vëllimeve të përgjithshme të punës.

- Në preventivat e punimeve të përcaktuara në DT, citohet se;

Vëllimet e parashikuara janë të përafërta. Projekti i plotë i zbatimit do të bëhet nga kontraktori dhe miratohet nga Autoriteti përgjegjës pas nënshkrimit të kontratës sipas nenit 37. Pra referuar

VKM Nr. 914 datë 29.12.14 në Rregullat e Prokurimit Publik, e ndryshuar, nenit 26 në Kontrata për Pune Publike, pika b, kjo kontratë do të trajtohet si një kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

c. Mbi vlerësimin dhe kualifikimin e operatorëve.

Me datë 17.04.2020, miratohet nga titullari i FSHZH raporti përmbledhës i procedurës. Me nr. 837 prot. Datë 17.04.2020, nënshkruhet marrëveshja kuadër me 20 Operatorë ekonomik, ku përcaktohen rregullat për kontratat të cilat do të lidhen përmes konkursit ndërmjet OE-ve që janë palë e marrëveshjes kuadër. Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është 12 muaj.

- Mbi zhvillimin e procedurës së minikonkursit dhe vlerësimit të ofertave datë 19.05.2020 në zbatim të Marrëveshjes Kuadër me objekt: Rindërtimi i objekteve arsimore në zonat e prekura nga tërmeti dhe ndarë në 7 (shtatë) lote.

- Në zbatim të Urdhrit të Prokurimit Nr.16/1, datë 12.03.2020, me objekt Rindërtimi i objekteve arsimore në zonat e prekura nga tërmeti dhe Urdhrit të Drejtorit Ekzekutiv për ngritjen e komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve dhe të vlerësimi të ofertave nr. 16/2, datë 12.03.2020, Komisioni i Vlerësimit të ofertave (KVO) në zbatim të nenit 43 të Aktit Normativ nr.9/2019, procedoi me hapjen e ofertave të paraqitura nga operatorët palë në marrëveshjet kuadër.

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës dhe palë në marrëveshjen kuadër nr. 837 prot., datë 17.04.2020.

1.	BOE: 4 SHPK NUIS K92005016L & A SHPK & AG SHPK.
2.	OE AG SHPK., NUIS K21622001M.
3.	BOE A.b SHPK. NUIS J69102508C & L sh.a NUIS K01730502E.
4.	OE A-S SHPK, NUIS J62903512E.
5.	BOE A.I SHPK. NUIS K91326028I & S SHPK NUIS K51501008J & I SHPK NUIS G10215236F.
6.	BOE: E SHPK NUIS K02727229P & B SHPK NUIS K71412003A & D SHPK NUIS K01731001M.
7.	BOE C SHPK NUIS J67902718S & A,C SHPK NUIS K01725001F.
8.	BOE D.AL SHPK NUIS K67917301H & AR SHPK
9.	BOE A.K SHPK NUIS J61812013R & E.K SHPK .
10.	BOE F SHPK NUIS J61922018S & Sh I SHPK NUIS J61924002T & A&E SHPK.
11.	OE G 2 SHPK., NUIS K58615301M.
12.	OE GJ, NUIS J62903456H.
13.	BOE In SHPK NUIS J66926804L & d SHPK NUIS L62717405H & C SHPK. NUIS J82916489E & Z SHPK NUIS J84003411K.
14.	BOE K K SHPK NUIS K71401004E & C R SHPK NUIS K81716011V & Xh SHPK NUIS J64103171M & M SHPK NUIS K62320011G & A Sh SHPK NUIS J72110003F.

15.	BOE ñPVKò SHPK dhe ñPò SHPK. dega në Kosove NUIS K61716013M & ñBXò SHPK NUIS K32618815N.
16.	BOE ñRTò SHPK NUIS J61901094G & ñA.E. Dò SHPK NUIS K21915002R & ñCMAò SHPK NUIS K82206013U.
17.	BOE ñSò SHPK NUIS J62903125G & ñShkò SHPK NUIS K68121808Ë.
18.	BOE ñSeò SHPK NUIS J94808405Q & ñDPò SHPK NUIS K11507003S & ñE/SHò SHPK NUIS J66902027T.
19.	BOE ñUNò SHPK NUIS J67902928O & ñG.ò SHPK NUIS J64324443V.
20.	BOE ñShò SHPK NUIS J64102272V & ñCRrKò NUIS K41517031H & ñItò SHPK NUIS L21512022F.

Për Lotin 2: "Objekti: ñRindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Krujë, me Ftesë për ofertë nr.837/1 datë 12.05.2020.

-Faza II hapja e ofertave në minikonkurs. Në datën 19.05.2020 në prezencë të KVO dhe të perfaqësuesve pjesëmarrës të operatorëve, u zhvillua procesi i hapjes e ofertave. Kanë qenë pjesëmarrës në fazën e minikonkursit me objekt ñRindërtimi i shkollës 9-vjecare dhe Kopshti Ramazan Jangozi dhe ñRindërtimi i Shkolles 9-vjecare dhe Kopshti Kastrioti Derveni, me fond limit **161,878,465 leke pa tvsh**, operatorët si më poshtë.

Pasqyra nr. 1 Operatorët pjesëmarrës në fazën e minikonkursit për lotin 2

NR	Operatorët pjesëmarrës LOTI 2	Oferta ekonomike leke pa tvsh	Afati/ Oferta kohore	Oferta e cilesise Po/Jo
1	ñAGò	153,784,542	6 muaj	po
2	AI & L VII	152,165,757	5.5 muaj	po
3	AIò & ñSiò & IBN	149,000,000	5.5 muaj	po
4	ñErò & ñBSò & ñTò	161,069,072.68	179 dite	po
5	ñCò & ñAò	161,069,072	180 dite	po
6	«DALò & ñARò	155,276,000	5.5 muaj	po
7	GJ	155,000,000	170 dite	po
8	«Iò & ñ6d-ò & ñCò & ñZò	146,453,500	3 muaj	po
9	«K Kò & ñC Rò & ñXhò & ñMò & ñAlò	127,883,900	4 muaj 24 dite	po
10	«PVKò & ñPò SHPK. & ñBXò	147,309,403	6 muaj	po
12	"RTò SHPK. & ñA.E. Dò SHPK. & ñC & M Aò.	160,259,680	5.5 muaj	po
13	«Sò SHPK. & ñShkò	137,596,695	6 muaj	po
14	«Sò SHPK. & ñD Pò & ñE/SHò	160,878,465	6 muaj	po
15	ñShò & ñCO Rr Kò & ñInfò	161,000,000	6 muaj	po

Burimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Loti 2: Vlerësimi: Objekti i minikonkursit: ñRindërtimi i objektit Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Ramazan Jangozi dhe ñRindërtimi i Shkolles 9-vjecare dhe Kopshti Kastrioti Derveni.

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj.

Operatori Ekonomik	Vlera pa TVSH	Piket Oferta Ekonomike (60 pike)	Muaj	Dite	Kohëzgjatja (ne muaj kalendari)	Piket Kohëzgjatja (30 pike)	Komente	Piket Cilesia (10 pike)	Piket Total
Al B & L	152,165,757.00	50.43	5.5		5.5	26.12		10	86.54
KK & C R& Xh & Albsh & M	127,883,900.00	60.00	4	24	4.8	30.00	4 muaj e 24 dite	10	100.00
S & Shk	137,596,695.00	55.76	6		6	23.94		10	89.71
AI & SF & IBN	149,000,000.00	51.50	5.5		5.5	26.12	Kastriot Derveni	10	87.62
PVK & P & BX	147,309,403.00	52.09	6		6	23.94		10	86.03
D-AL & Ar	155,276,000.00	49.42	5.5		5.5	26.12		10	85.53
Gj	155,000,000.00	49.50		170	5.6	25.72		10	85.22
RT & A.E.	160,259,680.00	47.88	5.5		5.5	26.12		10	84.00
Ag	153,784,542.00	49.89	6		6	23.94		10	83.84
2T & Ei & BS	161,069,072.68	47.64		179	5.9	24.43		10	82.07
Cu & Ag C	161,069,072.00	47.64		180	5.9	24.29		10	81.93
Se & Er & D P	160,878,465.00	47.69	6		6	23.94		10	81.64
Sh & CORr& Inf	161,000,000.00	47.66	6		6	23.94		10	81.60

-Komisioni ka vendosur të skualifikojë operatorin ekonomik të mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme

1. BOE nën SHPK & nën-Pò SHPK & nënCoò SHPK. & nënZdò SHPK.

Ofertë anomalisht e ulët në kohë për realizimin e objektit të kontratës (3 muaj nga 6 muaj të përcaktuar nga Autoriteti). Pas shqyrtimit të argumentimit të paraqitur nga ofertuesi BOE, autoriteti vlerëson se afati i realizimit të punimeve 3 muaj nuk është i mjaftueshëm për realizimin me cilësinë dhe vlerën e kërkuar nga Autoriteti Përgjegjës dhe si e tillë kjo ofertë skualifikohet.

-Komisioni i vlerësimit ka aplikuar për fazën e dytë metodologjinë sipas përcaktimit në pikën 2.12 nënjoftimi i kontratës si dhe pikës D. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese të fteses për ofertë, duke qenë se oferta e BOE nën SHPK & nënShkò SHPK është renditur në vendin e parë dhe fitues në lotin 7, BOE nënK Kò SHPK & nënR Rò SHPK & nënXhò SHPK & nënMò SHPK & nënShò SHPK fitues në Lotin 1 dhe BOE nënAl Cò SHPK. & nënS 2Fò SHPK & IBN SHPK fitues në Lotin e 6, rrjedhimisht KVO ka renditur në vendin e parë dhe fitues në Lotin e 2 BOE “Al B SHPK. & “L” sha.

Përzgjedhja është bërë duke pasur parasysh se operatorëve ekonomikë u është dhënë loti ku vlera e ofertës së tij është ulja më e favorshme ekonomike për autoritetin përgjegjës, në kombinimin e mundshëm të të gjitha loteve. Operatori i renditur i pari fitues Loti 2 është BOE ñA B & Lò. Në lidhje me këtë procedurë nuk ka patur ankimime administrative.

d. Mbi zbatimin e kontratës.

Kontrata e zbatimit të punimeve nr. 1194 prot. Datë 09.06.2020 është nënshkruar midis BOE ñAl Bò SHPK & ñLò SHPK, përfaqësuar nga z. O.B., znj. R. K dhe titullarit të FSHZH. Vlera e kontratës është 152,165,757 lekë pa TVSH dhe referuar VKM 143 datë 13.02.2020, përjashtohen nga TVSH kontraktorët. Afati i realizimit të kontratës është 5 muaj e 15 ditë.

Për këtë objekt është dhënë leje zhvillimi Nr.79 datë 20.05.2020 dhe leje ndërtimi Nr.184/1 dt.11.09.2020, dhënë nga Bashkia Krujë.

Ndërsa oponenca teknike e objektit është realizuar nga Instituti i Ndërtimit, Nr.1474/2 datë 10.07.2020, ku është cituar se projekti i plotëson kushtet teknike të projektimit.

Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve nr. 1216 prot. Datë 10.06.2020 është nënshkruar midis BOE G B SHPK & ñS.S. KA, përfaqësuar nga z. G.B., z. K.S. dhe titullarit të FSHZH. Vlera e kontratës është 1,282,906 lekë pa TVSH dhe referuar VKM 143 datë 13.02.2020, përjashtohen nga TVSH kontraktorët. Afati i realizimit të kontratës është 5 muaj e 15 ditë, sipas kontratës së zbatimit.

Sipas raportit teknik të mbikëqyrësit të punimeve nr. 2 me shkresë nr. 2013/1 prot. Datë 09.10.2020, dërgohet raporti mujor i objektit ñRindertimi i objekteve dy kate mbi tokë të Shkolles 9-vjecare Kastrioti dhe kopshti, Derven dhe Shkollës 9-vjecare Ramazan Jangozi dhe Kopshtin dy kate mbi tokë, ku konstatohet;

Punimet e zbatimit kanë filuar më 30.07.2020, për shkollën Kastrioti dhe datë 15.09.2020, për shkollën ñRamazan Jangozi. Gjatë kësaj periudhe është realizuar ngritja e kantierit, materialet e ndërtimit dhe afrimin e mjeteve.

Për shkollën Ramazan Jangozi nga data 15.09.2020 deri më 30.09.2020, janë realizuar punimet e prishje murature, shtresa betoni, punimet e gërmimeve dhe mbushjeve, punimet e betonit të shtresës së varfër, punimet e themelit dhe mureve deri në kuotën 0.05, betonim i dyshemesë në kuotën 0.05. Puna në shkollën Ramazan Jangozi është masën 13%.

Në lidhje me sa sipër, në observacionin e dërguar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit me nr. 425 prot. datë 28.01.2021, të protokolluara në KLSH me nr. 1028/5 prot. datë 29.01.2021, për Akt konstatimin nr. 1 datë 29.10.2020, citohet si më poshtë:

1) Pretendimi i subjektit të auditimit:

Lidhur me kërkesën e eksperiencën e punës të inxhinierëve nga FSHZH shpjegohet se kërkesat për numrin e inxhinierëve janë bërë në bazë të Kriterëve të Veçanta të Marrëveshjes Kuadër. Gjatë kësaj kohe magnituda e Lotit (apo numri i shkollave të cilat do të ndërtoheshin brenda një Loti) nuk ka qënë e përcaktuar saktësisht. Si rrjedhojë, në mënyrë të përafërt janë grupuar objektet e mundshme brenda një loti. Duke qënë se secili lot do të kishte minimalisht dy shkolla, stafi teknik është kërkuar i dubluar pasi zbatimi i objekteve do të kryhej paralelisht. Duke pasur parasysh natyrën e ndërtimit, (shkollat cilësohen si objekte të rëndësishme të veçantë) si dhe kohën e shkurtër të zbatimit të tyre, është kërkuar që stafi të ketë eksperiencë të mjaftueshme dhe të jetë prezent dhe i dedikuar në secilin objekt.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë argumentimet e mësipërm, pasi vetë AK ka vendosur si kriter në DT që OE nuk lidhin kontratë tjetër, nëse nuk i ka përfunduar punimet në masën 40 % të vëllimit të përgjithshëm të punës së një kontrate në vazhdim. Përsa sipër, nuk është argumentuar teknikisht në observacion vendosja e kriterit të vjetërsisë dhe numri i inxhinierëve nuk përputhet me volumin e punimeve.

2) Pretendimi i subjektit të auditimit:

Në lidhje me kriterin e vendosur për numrin e punonjësve të OE, kriter i cili pretendohet nga ana juaj se ngushton konkurrencën, nga sa më sipër, shpjegojmë se për arsye të kohës së shkurtër dhe proceseve teknologjike të ndërtimit, të cilat do të mbivendosen në rastin konkret, si dhe kantierëve paralele, është argumentuar që numri i punëtorëve të jetë ai i përcaktuari. Pretendimi juaj se ky kriter ka ulur konkurrencën, nuk qëndron gjithashtu sepse operatorët janë bashkuar për këtë qëllim, duke formuar JV. Këtë fakt e vërteton pjesëmarrja e lartë e operatorëve në Marrëveshjen kuadër dhe në kontratat e lidhura.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Grupi i auditimit merr pjesërisht në konsideratë argumentimet e mësipërm, pasi kriteret kanë orientuar për tu bashkuar domosdoshmërisht operatorët ekonomikë, me qëllim arritjen e numrit të punonjësve. Pra, vështirësohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë.

V. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se shërbimi i projektit nuk është prokuruar, duke shmangur procedurat prokurese për konkurs projektimi ose shërbim konsulence, si dhe nuk ka komunikim shkresor për hartimin e këtij projekti, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 nëpër prokurimin publik, i ndryshuar, neni 35 "Konkursi i projektimit" dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 37, 38 dhe 77. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk ka gjurmë të zhvillimit të këtij projekti dhuratë nga shoqëria projektuese nëXH & Mò Shpk. Nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë marrjen në dorëzim apo miratimin e këtij projekti nga ndonjë strukturë e specializuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Krujë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin e një projekti të pamiratur. Nga strukturat e ngarkuara nga titullari i Bashkisë Krujë, për procedurat e prokurimit të punëve publike që do zhvillohen në vazhdimësi, të merren masa të zbatohen rregullat e prokurimit publik të projekteve, duke realizuar konkurse projektimi apo shërbime konsulence. Në rast se projekti do të ndjekë rrugën ligjore si dhuratë nga shoqëritë projektuese, AK të marrë masa për marrjen në dorëzim të projektit me grup të specializuar, si dhe kontabilizimin e tij.

Vazhdimisht

2. Gjetje nga auditimi: Shoqëria nëXH & Mò Shpk, e cila është hartuesja e projektit të zbatuar, rezulton të jetë edhe kolaudatore e realizimit të punimeve të objektit. Ky veprim është në

kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr.8402 nëPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Krujë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për caktimin e projektuesit si kolaudator të punimeve dhe për procedurat e prokurimit të punëve publike që do zhvillohen në vazhdimësi, të merren masa për zbatimin e legjislacionit të disiplinimit të punimeve, ku të përcaktohen kolaudatorë që nuk kanë lidhje apo konflikt interesi me projektimin e veprës, me qëllim kontrollin korrekt dhe të painfluencuar të zbatimit të punimeve.

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi: Në llogaritjen e fondit limit, rezultoi se 44.5% të të gjithë zërave të punës, janë të cituara nëanalizë (nuk ndodhen në manualin e çmimeve) dhe në dosje nuk ndodhet asnjë analizë çmimi, në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publik në ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor nuk i është referuar një ose më shumë alternativave, duke mos argumentuar plotësisht përlllogaritjen e fondit limit.

- Në dy zëra pune (pompa e kaldajës dhe pompa e ngrohjes) është përcaktuar edhe emri (lloji) i materialit (pa cituar nëkuivalent), në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "Për prokurimin publik" neni 23 "Specifikimet teknike", pika 2 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

3.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Krujë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përlllogaritjen e fondit limit të paargumentuar teknikisht dhe gjatë zhvillimit të procedurave konkurruese për projektim, të merren masa të zbatohen kushtet dhe standardet teknike të projektimit, ku të përlllogaritet saktë vlera e fondit limit dhe në specifikimet teknike nuk duhet të ketë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët nëose ekuivalent të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Vazhdimisht

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt nëRikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestre Thumanë, në Bashkinë Krujë, u konstatua se Dokumentet e Tenderit përmbajnë disa shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik. Dokumentet e tenderit, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me nenin 61, pika 2 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publik në ndryshuar. Kriteret e kualifikimit, si: numri i paargumentuar për 200 punonjës, numri dhe lloji i makinerive jo sipas natyrës së objektit, kriteri skualifikues për vizitën në kantier, etj., janë diskriminuese dhe kanë kufizuar konkurrencën, duke favorizuar operatorë të caktuar, në shkelje të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 nëPër prokurimin publik, i ndryshuar, neni 1. Janë vendosur kriteret skualifikuese që nuk gjejnë asnjë mbështetje ligjore, të cilat i kanë mundësuar OE fitues që ofertën ekonomike ta bënte në vlerë afër fondit limit (siç edhe e ka ndodhur në fakt 99.82% e fondit limit) *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Krujë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve dhe

nëpërmjet Njesisë së Prokurimit, në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i vendosur të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxitur konkurrencën dhe për të mos favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar, duke dhënë argumente për secilin kriter në mënyrë të dokumentuar, i cili të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

Vazhdimisht

5 Gjetje nga auditimi. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) të dokumenteve të paraqitura nga BOE e shpallur fitues në SHPK & "S" SHPK, rezultoi se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 15.06.2019, OE SHPK është kontraktori kryesor dhe merr përsipër 70 % të punimeve. Për pasojë në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 nëpër miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 74 pika 3, OE SHPK duhet të kishte mesatarisht për periudhën e kërkuar 140 punonjës (70% e 200 punonjësve të kërkuar), ndërkohë që ka mesatarisht 122 punonjës. Në këto kushte ky OE nuk plotëson kriteret e kualifikimit dhe BOE e shpallur fitues duhej skualifikuar. Ky veprim ka shkaktuar mungesë efektiviteti në përdorimin e fondeve publike, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore të prokurimit *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi. Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Krujë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve dhe të marrë masa për eliminimin e shpalljes fitues të operatorëve ekonomikë me mangësi në plotësimin e kriterëve kualifikuesë, në prokurimet për punë publike, mallra/shërbime me shkelje ligjore, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Vazhdimisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumenteve të vëna në dispozicion nga Bashkia Krujë, rezultoi se vendimi i prishjes së "Shkollës 9-vjeçare Thumanë", është në tejkalim të kompetencave të Kryeinspektorit të IMTV-së. Kjo sepse, objekti në fjalë nuk ishte i kundërligjshëm dhe për pasojë nuk është subjekt i nenit 5, pika d, i Ligjit Nr. 9780 datë 16.07.2007 nëpër inspektimin dhe mbrojtën e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, i ndryshuar, i cili trajton objektet e jashtëligjshme. Objekti përpara se të prishej, duhet të ishte pajisur me leje për prishje ndërtimi, kompetencë e Kryetarit të Bashkisë Krujë, në përputhje me kërkesat e Nenit 39, pika 1, të Ligjit 107/2014 nëpër planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, i ndryshuar dhe Nenin 11, germa 1, të VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 nëpër Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Krujë, në rastet e prishjes së objekteve të dëmtuar nga tërmeti ose jo, të cilat nuk janë objekte të paligjshme, të merren masa për nxjerrjen paraprakisht të lejes për prishje ndërtimi, sipas përcaktimeve në legjislacionin e planifikimit dhe kontrollit të territorit.

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi: Për objektin "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë", është dhënë një leje për kryerje punimesh, i firmosur nga Kryetari i Bashkisë Krujë, z. A. B., jo nëpërmjet sistemit elektronik të aplikimit, në kundërshtim Nenin 43, Aplikimi për

leje ndërtimi, pika 1 të Ligjit 107/2014 nëPër planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Nga titullari i Bashkisë Krujë, të merren të gjitha masat për pajisjen me leje ndërtimi nëpërmjet sistemit elektronik, për të gjithë rikonstruksionet e objekteve me financim publik, megjithëse janë në inventarin e Bashkisë, sipas përcaktimeve në legjislacionin e planifikimit dhe kontrollit të territorit.

Vazhdimisht

8. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i Akt-konstatimit të datës 30.11.2019 i mbajtur nga grupi i konstatimit të gjendjes së objektit nëRikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë të dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019, ku objekti është evidentuar si i pabanueshëm, rezulton se është e pamundur të identifikohen emrat e personave që kanë qenë pjesë e grupit të inspektimit (megjithëse nga punonjësit e bashkisë pretendohet që kanë qenë inxhinierë nga grupi grek i emergjencave civile) dhe rekomandimet në lidhje me këtë objekt. Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Bashkia Krujë, nuk evidentohet asnjë urdhër për ngritjen e një grupi ekspertësh për vlerësimin e këtij objekti.

Në Akt-konstatimin Nr.01, datë 03.12.2019, të mbajtur nga grupi i inspektimit i përbërë nga z. G.I. dhe znj. Xh.D., përkatësisht mbikëqyrës dhe kolaudator i kontratës për nëRikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë dhe z. A.I., inxhinier, objekti është konsideruar i pabanueshëm, dëmet në objekt janë cilësuar të larta dhe është rekomanduar që të prishet. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Bashkia Krujë, nuk evidentohet se me çfarë tagri grupi i inspektimit ka kryer akt-konstatim për këtë objekt, pa patur urdhër ose detyrë të ngarkuar nga Bashkia Krujë, apo nga ndonjë institucion tjetër shtetëror. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 26, datë 15.01.2020 nëPër kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Nga titullari i Bashkisë Krujë, të merren masa që në vazhdimësi, vlerësimi teknik i objekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 të bëhen nga persona apo grupe teknike të autorizuar dhe prishjet e ndërtimeve të rezultuara si të dëmtuara nga tërmeti, të realizohen sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi : Në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, më datë 16.03.2020 janë hedhur në SPE, kriteret e pjesëmarrjes për lotin 2 nëRindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Krujë. Për shkollën nëRamazan Jangozi janë planifikuar 84,064,787 lekë dhe së bashku me objektin nëRindërtimi i objekteve dy kate mbi tokë të Shkollës 9-vjeçare nëKastrioti dhe kopshti, Dervenë rezulton vlera prej 161,878,465 lekë pa TVSH. Nga auditimi i DT, konstatohet mospajtueshmëri e plotë me Neni 41 të Aktit normativ nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore" nëParimet e prokurimit publik për rindërtiminë pika b 1. Prokurimi publik për rindërtimin siguron nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë. Janë vendosur 2 kërkesa kualifikuese (numri total i punonjësve 260 dhe eksperiencë 15, 10 dhe 5 vjeçare e inxhinierëve) të paargumentuara dhe që nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2A, faqe 36-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Titullari i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë përvendosje e kriterëve në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve dhe në procedurat e prokurimit të punëve publike që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që

kriteret kualifikuese të hartohen në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, ku çdo kriter duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Vazhdimisht

B.1. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 nëPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit nën 15 shkronja (b) dhe (c) nëTë drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98 - 102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 nëKodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë, nenet 21-33 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 nëPër vetëqeverisjen vendore, dhe pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik në ndryshuar, nga ana e titullarit të Bashkisë Krujë, të nxirren aktet administrative përkatëse duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi zbatues të ndiqet procesi me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 7,104,751 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren për prishjen e objektit, konstatohet se nga AK nuk janë marrë masa për evidentimin dhe kontabilizimin e materialeve të cilat nuk janë prekur nga shembja e objektit, pasi kanë qenë zëra punimesh dhe pajisje jashtë objektit dhe AK nuk ka realizuar vlerësim përpara prishjes së objektit. Zërat e punimeve nëZgara dekorative hekuri me figuracion mesatar në rrethimin e shkollës, nëPortë dekorative rrëshqitëse, nëPemë dekorative, nëStola druri dhe rezervuar i lëndës djegëse, të cilat nuk janë prekur nga prishja e objekti, në total kanë vlerën prej **5,627,178 lekë pa TVSH**. Nga AK nuk janë marrë masa për kontabilizimin apo dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve të cilat nuk ishin prekur nga tërmeti. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik*", pika 108.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Krujë, të marrë masa nëpërmjet një grupi pune, për të nxjerrë përgjegjësitë për mosveprimin në lidhje me kontabilizimin apo përdorim/tjetërsimin e aktiveve dhe materialeve të paprekura nga prishja e godinës së shkollës në Thumanë dhe të ndjekë të gjitha procedurat për riadministrimin e këtyre aktiveve, apo arkëtimin e vlerës së tyre prej **5,627,178 lekë pa TVSH** nga personat përgjegjës.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në objektin "*Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë*", "*Bashkia Krujë*", nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, si nëTrarë themëli monolit b/a C16/20, nëFV hekur betoni D>12 mm, etj, në vlerën totale **1,477,573 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 4290 prot., datë 13.06.2019, të lidhur mes titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Krujë dhe BOE fitues nëEò SHPK & nëRò SHPK & "S" SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Krujë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,477,573 lekë pa tvsh** nga BOE fitues nëEò SHPK & nëRò SHPK & "S" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën Nr. 4290 prot., datë 13.06.2019, me objekt "*Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare +*

ndërtim palestër, Thumanë", Bashkia Krujë", vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

B.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Projekt - Preventivi i objektit "*Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestër, Thumanë*" hartuar nga shoqëria ÆXh & Mò Shpk, *nuk ka parashikuar asnjë zë pune që ka të bëjë me përforcimin strukturor të shkollës*, ose ndërhyrje në strukturën mbajtëse të objektit, pavarësisht se në narrativin e tij, relacioni citon që objekti është i dëmtuar si nga tërmeti i Korrikut 2018, ashtu edhe nga amortizimi i saj për shkak të vjetërsisë së objektit (viti 1964). Punimet ndërtimore të shkollës përfshijnë vetëm punime për përmirësimin e rifiniturës (suvatime, hidroizolime, shtresa, etj.) dhe punime elektrike dhe hidraulike.

Në kushtet e rënies së tërmetit të datës 26.11.2019, të dëmeve dhe pasojave që patën në banesa dhe ndërtime të tjera, objekti dy kate i shkollës 9-vjeçare, Thumanë mbasi janë konstatuar dëmtime strukturore të tij, është prishur në datë 04.12.2019, ku është mbajtur dhe procesverbali i prishjes Nr.7865 datë 10.12.2019.

-Objekti shkollë 9-vjeçare dhe Kopshti Ramazan Jangoziò, e ndodhur në Thumanë, rezulton e demoluar dhe është parashikuar për ndërtim me kapacitet 250 nxënës.

- Më datë 16.03.2020 janë hedhur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), kriteret e pjesëmarrjes për lotin 2 Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Krujëò. Për shkollën Ramazan Jangoziò janë planifikuar 84,064,787 lekë.

Mbështetur ngjarjeve dhe rrethanave, ku shkollë rezultoi e dëmtuar nga tërmeti i Nëntorit 2019 dhe e pashfrytëzueshme, konstatohet se ky projekt rikonstruksioni ka shkaktuar përdorim pa efektivitet dhe efikasitet të fondeve të buxhetit të shtetit, për shkak të mos studimeve, projekteve të thelluara për përforcimin strukturor të shkollës, në vlerën **40,672,479 lekë pa TVSH** (58,892,767 lekë vlera totale - 18,220,288 lekë që i përket palestrës së ndërtuar dhe të padëmtuar) (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Krujë gjatë zhvillimit të procedurave konkurruese për projektim, të merren masa të zbatohen kushtet dhe standardet teknike të projektimit, ku të vlerësohet saktë aftësia mbajtëse e godinave të vjetra, për të konkluduar nëse godinat e vjetra duhet të përforcohen apo të ndërtohen të reja, në mënyrë që të mos krijohen përdorime pa efikasitet të fondeve publike.

Vazhdimisht

C. MASA ADMINISTRATIVE

C.1 Për Agjencinë e Prokurimit Publik

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publikò, i ndryshuar, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuara dhe pasqyruara në dokumentet e auditimit (Akt-konstatim, Projektraport Auditimi dhe Raport Përfundimtar Auditimi), bazuar në nenin 15 germa (c) dhe (ç), si dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Krujë**, të vlerësojë shkeljet e

konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me këto shkelje, për 5 punonjës si më poshtë:

1. **Z. R. B.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit,
 2. **Z. G. H.**, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Prokurimeve, në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi në procedurën e prokurimit me objekt **Rekonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestere Thumanë, Bashkia Krujë**, janë vendosur kriterë për kualifikim, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 **Për prokurimin publik**, i ndryshuar, neni 1 dhe neni 46, si dhe në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar **Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**, **neni 26 "Kontrata për punë publike"** pika 5, duke zvogëluar në mënyrë të ndjeshme konkurrencën dhe favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.
 3. **F. C.**, në cilësinë e Kryetarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt **Rekonstruksioni i shkollës 9 vjeçare dhe ndërtim palestere Thumanë, Bashkia Krujë**,
 4. **I. H.**, në cilësinë e anëtarit të KVO-së
 5. **S. P.**, në cilësinë e anëtarit të KVO-së
- pasi është kualifikuar BOE **Shërbimi SHPK & Shërbimi SHPK & Shërbimi SHPK**, në kundërshtim me nenin 46, pika 1.b të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 **Për prokurimin publik**, i ndryshuar, kur nga kjo BOE nuk plotësohet kriteri i kërkuar për personelin e nevojshëm.
- (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

C.2. Për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit

I. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 12, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 **Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit** i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruara në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, **Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i rekomandojmë, Kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit**, të vlerësojë shkeljen e konstatuar dhe të vendosë masë administrative me gjobë për:

1. **Z. A. B.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Krujë, për shkeljen e konstatuar në lidhje me emërimin e kolaudatorit, i cili ka konflikt interesi për shkak se është njëkohësisht edhe projektues i objektit.

II. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 **Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit** i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 **Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit** i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruara në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 **Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme**, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, **Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Krujë** t'a kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të

vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve të cilësuar më poshtë:

2. OE “E” SHPK, përfaqësuar nga z. G. I., për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve;

3. OE “Xh & M” SHPK, përfaqësuar nga znj. Xh. D., për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE:

Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 nëPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, germat (b, c, ç) e nenin 58-*ñLlojet e masave disiplinore*, të Ligjit nr. 152/2013 nëPër nëpunësin civil, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 nëPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 nëPër vetëqeverisjen vendore, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Krujë që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit Tematik të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për 1 (një) punonjës, si më poshtë:**

a. “Largim nga Shërbimi civil”, neni 58 germa (ç) të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, për punonjësin:

Z. S. Sh. me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor.

Për shkeljen e mëposhtme:

- Vendimi i prishjes së "Shkollës 9-vjeçare Thumanë" me Nr. 241, datë 02.12.2019, i firmosur nga z. S. Sh., është në tejkalim të kompetencave të Kryeinspektorit të IMTV-së, sepse objekti në fjalë nuk ishte i jashtëligjshëm dhe për pasojë nuk është subjekt i Nenit 5, pika d, i Ligjit Nr. 9780 datë 16.07.2007 nëPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme, i ndryshuar, i cili trajton objektet e jashtëligjshme. Objekti përpara se të prishej, duhet të ishte pajisur me ñLeje për prishje ndërtimi, tagër e titullarit të Bashkisë Krujë, në nenin 39, pika 1, të Ligjit 107/2014 nëPër planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, dhe nenin 11, pika ç, të VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 *“Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Krujë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin

e ecursë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 për Nëpunësin Civil, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 për Nëpunësin Civil, i ndryshuar.

Për sa më sipër është hartuar ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

KONTROLI I LARTË I SHITIT

V. ANEKSE

Lista e shkurtimeve:

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standartet Ndërkombëtare të Auditimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
NJP	Njësia e Prokurimit
TAK	Titullari i Autoritetit Kontraktor
AK	Autoriteti Kontraktor
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorrit
APP	Agjencia e Prokurimit Publik

Aneksi 1

Pajisjet dhe zërat e punës që mund të ishin riadministruar

Nr.	Zëri	Emërtimi	Njwsia	Sasia				Vlera (lekë)
11	An	F.v zgara dekorative hekuri me figuracion mesatar rrethimi i shkollës	m2	354				2,301,000
12	An	F V portë dekorative rrëshqitëse	m2	11				74,778
13	An 169	Furnizim mbjellje peme dekorative	copë	100				1,601,400
14	An	F.v stola druri për pushim	copë	50				1,400,000
27	An	Rezervuar i furnizimit me lendw djegwse, kapc 500 litra	copë	1				250,000
		Shuma						5,627,178
		T.V.SH						1,125,436
		VLERA TOTALE						6,752,614

Aneksi 2

Tabela përmbledhëse e punimeve të situacionuara dhe të pakryera në fakt.

		<i>Rikonstruktion i shkollës 9-vjeçare + ndërtim palestër, Thumanë</i>	Njësia	Çmimi	Sasi Situacion	Sasia Faktike	Diferenca Sasi	Diferenca (lekë)
Nr.	Zëri	Emërtimi		Lekë	Njësi	Njësi	Lekë	Lekë
		Punimet në palestër						
4	2.116/1	Trarë themeli monolit b/a C16/20	m3	11750	108	53.4	55	641,550
11	2.279	Shtresë dërrasa FM 2.5cm, mbi binarë druri.	m2	510	359	0	359	183,090
21	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h-8m	m2	520	563.00	0	563	292,760
23	2.167	F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	103498	10.48	7.00	3.48	360,173
		DIFERENCA						1,477,573
		T.V.SH						295,515
		SHUMA TOTALE						1,773,088